



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.134

7 tetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 313 datë 16.9.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes “ISTISNA’A” dhe marrëveshjes së agjencisë “ISTISNA’A” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin “Rindërtimi i rrugëve dytësore dhe lokale”	7367
Vendim i Kuvendit nr.62, datë 23.9.2010	Për dhënie pëlqimi për emërimin e zotit Bashkim Dedja Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	7386
Dekret nr.6679 datë 15.9.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	7387
Udhëzim i MMPAU dhe MB nr.3, datë 16.8.2010	Për rregullat dhe procedurat e pajisjes së shtetasve të huaj, rezidentë dhe jorezidentë, me leje gjuetie	7388
Udhëzim i MPPT nr.17, datë 2.9.2010	Mbi rregullat e zbatueshme të operimit në fushën e shërbimeve ajrore	7389
Udhëzim i MF nr.32, datë 21.9.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”	7402
Udhëzim i MB nr.343, datë 4.10.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.160, datë 25.1.2007 “Për procedurat e ndalimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të mjeteve për kundërvajtje administrative”, të ndryshuar	7403

LIGJ
Nr.10 313, datë 16.9.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES “ISTISNA’A” DHE MARRËVESHJES SË
AGJENCISË “ISTISNA’A” NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (IDB) PËR PROJEKTIN
“RINDËRTIMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja “ISTISNA’A” dhe marrëveshja e agjencisë “ISTISNA’A” ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin “Rindërtimi i rrugëve dytësore dhe lokale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6688, datë 27.9.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Nr. i projektit: ALB-0027

**MARRËVESHJA “ISTISNA’A”
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM MBI PROJEKTIN E RINDËRTIMIT TË RRUGËVE DYTËSORE
DHE LOKALE**

Kjo Marrëveshje është lidhur më ___/___/___1431H (që i korrespondon ___/___/___2010G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu i quajtur “blerësi” ose “Këshilli i Ministrave”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu i quajtur “shitësi” ose “IDB”)

Blerësi dhe shitësi referohen këtu veçmas si “pala” dhe bashkërisht si “palët”.

Duke marrë në konsideratë se:

A) Blerësi i ka kërkuar shitësit të kryejë punime për projektin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri, të përshkruar në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje (këtu i quajtur “punimet”) për përdorim në projektin e përshkruar në aneksin II të kësaj Marrëveshjeje.

B) Shitësi ka rënë dakord të kryejë punimet për blerësin për një shumë totale që nuk kalon 30 000 000. 00 USD (tridhjetë milionë dollarë amerikanë) me një çmim shitjeje që duhet të përcaktohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe që do të paguhet nga blerësi për shitësin brenda 11 (njëmbëdhjetë) vjetësh pas periudhës së maturimit prej 4 (katër) vjetësh, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

C) Termat dhe kushtet e përmendura në paragrafin (B) të kësaj Marrëveshjeje i janë komunikuar dhe janë pranuar nga blerësi.

Rrjedhimisht, shitësi dhe blerësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Përkufizime, interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që jepet përbri secilit prej tyre si më poshtë:

Marrëveshje e agjencisë: Marrëveshja e një date të caktuar ndërmjet shitësit dhe blerësit, me anë të së cilës blerësi do të veprojë si agjent i shitësit në përzgjedhjen e kontraktuesit dhe mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve.

Shuma e aprovuar: 30 000 000. 00 USD \$ (vetëm tridhjetë milionë dollarë amerikanë).

Kostoja e kapitalit: Kostoja totale e përfundimit të punimeve që përfshin çmimin e pagueshëm për kontraktuesin sipas kontratës, dhe çdo kosto dhe shpenzim tjetër të shkaktuar nga shitësi për ose në lidhje me kryerjen e punimeve.

Kontrata: Kontrata për përfundimin e punimeve ose pjesëve të tyre, e lidhur në emër të shitësit nga blerësi me kontraktuesin.

Kontrata e parë: Kontrata e parë e lidhur për përfundimin e një pjese të punimeve, e lidhur në emër të shitësit nga blerësi me kontraktuesin.

Kontraktuesi: Shoqëria së cilës i besohet kryerja e punimeve ose çdo kontraktues tjetër që mund të angazhohet për të njëjtin qëllim.

Konsulenti i planprojektit: Subjekti/personi, të cilit i besohet përgatitja e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimet teknike, vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e rrugëve përkatëse.

Dokumenti i hollësishëm i planprojektit: Dokumenti që mbulon përgatitjen e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimeve teknike, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e projektit.

Disbursimi: Paga aktuale ose ndonjë pjesë e shumës së aprovuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Data e hyrjes në fuqi: Data në të cilën shitësi e shpall Marrëveshjen në fuqi, në përputhje me nenin 13 të saj.

Disbursimi i parë: Paga e parë pas datës së hyrjes në fuqi, në përputhje me politikat dhe udhëzimet përkatëse të IDB-së.

Periudha e maturimit: Periudha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe përfundon pas 48 (dyzet e tetë) muajsh.

Projekti: Projekti i përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje.

Çmimi i shitjes: Çmimi i shitjes së punimeve, i pagueshëm nga blerësi për shitësin, në përputhje me nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Taksa: Çdo taksë, detyrim, tatim ose çdo tarifë tjetër e një natyre të ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo gjobë të pagueshme në lidhje me çdo pamundësi për të paguar ose vonesë në pagesën e sa më sipër).

Dollarë amerikanë dhe "US\$": Monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Norma SWAP e USD: Norma e kuotuar në ekranet Reuters USDSFIX= një ditë punë para datës së disbursimit të parë.

Punimet: Punimet ose pjesë të tyre të përshkruara në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo kontratë përkatëse.

1.2 Në këtë Marrëveshje:

a) Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë personat përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referencat ndaj një shtojce, neni apo seksioni të specifikuar është një referencë ndaj asaj shtojce, neni apo seksioni të kësaj Marrëveshjeje.

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen e agjencisë dhe që nuk janë përcaktuar këtu kanë të njëjtin kuptim siç u është dhënë në Marrëveshjen e agjencisë.

c) Titujt e neneve dhe seksioneve janë vendosur vetëm për lehtësi reference dhe nuk përdoren për të përcaktuar, interpretuar ose kufizuar ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Preambula dhe shtojcat si pjesë të Marrëveshjes

Preambula dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 3

Kryerja e punimeve

3.1 Shitësi bie dakord të përfundojë punimet në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe blerësi bie dakord të marrë në dorëzim punimet në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe të paguajë çmimin e shitjes.

3.2 Për shmangien e çdo dyshimi, blerësi bie dakord që shitësi të kryejë punimet nëpërmjet kontraktuesit, i cili duhet të përzgjidhet në përputhje me dispozitat përkatëse të përcaktuara në Marrëveshjen e agjencisë.

3.3 Agjencia zbatuese përgjegjëse për zbatimin e projektit në emër të blerësit do të jetë Fondi Shqiptar për Zhvillim.

Neni 4

Koha për përfundimin e punimeve

Në bazë të neneve 6 dhe 10 të kësaj Marrëveshjeje, kryerja e punimeve do të përfundojë brenda 4 (katër) vjetësh nga data e disbursimit të parë.

Neni 5

Përfundimi i Marrëveshjes

5.1 Në bazë të seksionit 12.2 të kësaj Marrëveshjeje, blerësi mund t'i kërkojë shitësit t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje dhe të anulojë shumën e miratuar të kontratës ose çdo pjesë të saj.

5.2 Nëse disbursimi nuk është bërë nga shuma e aprovuar përpara përfundimit, nëse shuma e miratuar është anuluar sipas nenit 12 të kësaj Marrëveshjeje, kjo e fundit do të konsiderohet automatikisht e përfunduar.

5.3 Përpara nënshkrimit të kontratës, shitësi, me anë të një njoftimi drejtuar blerësit, mund të përfundojë këtë Marrëveshje në ndonjë prej rasteve të mëposhtme:

a) Pamundësia e blerësit për të plotësuar detyrimet e tij për të paguar çdo shumë të kërkueshme nga ai për shitësin ose ndonjë organ të inkorporuar pranë shitësit, sipas çdo marrëveshjeje të ndryshme nga Marrëveshja në fjalë;

b) Ka ndodhur një situatë e jashtëzakonshme, e cila: (i) e bën të pamundur, sipas mendimit të shitësit, që blerësi të plotësojë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose (ii) pengon arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo Marrëveshje.

c) Një përfaqësim i bërë nga blerësi ose çdo deklaratë e dhënë dhe me synimin që të mbështetet nga shitësi në zhvillimin e projektit për miratim ose për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje, do të kishte qenë i paplotë ose i gabuar në ndonjë aspekt material.

5.4 Në rast pezullimi, nuk do të kryhet asnjë disbursim nga shuma e aprovuar nga momenti që një njoftim pezullimi i është dhënë blerësit derisa shitësi të jetë plotësisht i bindur se ngjarja ose ngjarjet që kanë shkaktuar këtë pezullim kanë pushuar së ekzistuari ose derisa shitësi të ketë njoftuar blerësin se shitësi është riangazhuar për të kryer punimet, cilado që ndodh më parë; megjithatë, me kusht që në rast të ndonjë njoftimi riangazhimi, sipërmarrja për të kryer punimet të jetë vetëm në shkallën dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë njoftim dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të cenojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet ligjor të shitësit në lidhje me çdo ngjarje tjetër ose ngjarje të mëtejshme të përshkruar në këtë seksion.

5.5 As shitësi, as blerësi nuk kanë detyrime të mëtejshme ndaj njëri-tjetrit që nga data e anulimit të Marrëveshjes, sipas seksionit 5.1, 5.2 ose 5.3 të këtij neni, me kusht që ky përfundim të mos cenojë ndonjë detyrim të shkaktuar ose të drejtë që i lind çdo pale përpara këtij përfundimi.

5.6 Pavarësisht nga përfundimi i Marrëveshjes, blerësi do të vazhdojë të bashkëpunojë dhe të ndihmojë shitësin në kompensimin nga kontraktuesi të asaj pjese të çmimit të kontratës dhe të çdo shume që mund të jetë disbursuar nga shitësi para përfundimit të kontratës.

Neni 6

Pranimi i punimeve nga blerësi

Blerësi do të konsiderohet të ketë pranuar në mënyrë të përvokueshme punimet për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, në momentin që ai nënshkruan certifikatën përfundimtare të pranimit siç përcaktohet në Marrëveshjen e agjencisë.

Neni 7

Pronësia dhe rreziku

Titulli dhe rreziku në punime do t'i kalojë blerësit pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit.

Neni 8

Kushtet e punimeve

8.1 Pa cenuar sa më sipër, shitësi nuk do të ketë asnjë lloj përgjegjësie ose detyrimi ndaj blerësit ose ndonjë personi apo subjekti tjetër në lidhje me:

a) çdo detyrim, humbje ose dëmtim të shkaktuar (ose që dyshohet të jetë shkaktuar) direkt ose indirekt nga punimet, ose nga ndonjë mungesë e tyre, pamjaftueshmëri, ose defekt apo nga rrethana të tjera që lidhen me të;

b) përdorimin apo operimin e punimeve ose çdo rreziku që lidhet me to;

c) çdo ndërprerje të shërbimit, humbje të biznesit ose përfitim të pritshëm apo dëmet që lindin si rrjedhojë e tyre.

8.2 Shitësi merr përsipër t'i japë blerësit përfitimin e çdo garancie, kushti ose autorizimi që lidhet me punimet dhe që mund t'i jetë dhënë nga kontraktuesi shitësit dhe që është shqyrtuar dhe pranuar nga blerësi, dhe të gjitha kushtet ose garancitë e tjera që mund të nënkuptohen me ligj ose njihen institucionalisht në favor të shitësit. Për më tepër, shitësi do të ndërmarrë çdo masë tjetër nëse blerësi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme t'i japë mundësinë blerësit të ankohet ndaj kontraktuesit.

Neni 9

Pagesa e çmimit të shitjes

9.1 Çmimi i shitjes është 44 490 105 US\$ (dyzet e katër milionë e katër qind e nëntëdhjetë mijë e njëqind e pesë dollarë amerikanë) që përbëhet nga kostoja e kapitalit plus një shumë shtesë prej 5.1% (pesë pikë një për qind) në vit. Ky çmim shitjeje do të rillogaritet pas konstatimit të kostonë së kapitalit në fund të periudhës së maturimit

9.2 Blerësi do të paguajë çmimin e shitjes në 22 (njëzet e dy) këste të njëpasnjëshme të barabarta gjashtëmuajore, i pari prej të cilëve bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit të periudhës së maturimit. Shitësi do t'i dërgojë blerësit grafikun e pagesës së çmimit të shitjes menjëherë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit.

9.3 Në bazë të seksionit 9.6 të këtij neni, çdo pagesë që duhet të kryhet nga blerësi për shitësin si më poshtë do të bëhet në një monedhë të konvertueshme, të pranueshme nga shitësi me vlerë në datën e kërkueshme në llogarinë e shitësit ose në çdo mënyrë tjetër sipas njoftimit me shkrim që shitësi mund t'i bëjë herë pas here blerësit.

9.4 Çdo pagesë e kërkueshme, si më poshtë do të konsiderohet të jetë kryer rregullisht kur ndonjë prej bankave të mëposhtme i konfirmon shitësit marrjen e kësaj pagese në llogarinë e shitësit.

Në dollarë amerikanë:
Nr. i llogarisë GB36SINT609280001591 11
Gulf International Bank (UK)
Ltd, One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Telex No. 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L.

Në sterlina:
Nr. i llogarisë GB13SINT60928000159137
Gulf International Bank (UK)
Ltd, One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Nr: Telex 8812261/2
Swift Code: SINTGB2L.

Në euro:
Nr. i llogarisë FR7643899000019696500151088
Union de Banques Arabes et Francaises (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex, France
Nr. Telex 610334 UBAF
Swift Code: UBAFRPPXXX

9.5 Nëse një pagesë bëhet e kërkueshme në një ditë që nuk është ditë pune, pagesa do të kryhet në ditën tjetër pasardhëse të punës.

9.6 Të gjitha pagesat e bëra nga blerësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa zbritje ose në llogari të çdo takse, kompensimi, kundërkërkese ose ndonjë çështjeje tjetër. Nëse blerësi i kërkohet me ligj të bëjë ndonjë zbritje ose mbajtje nga ndonjë shumë e pagueshme prej tij, shuma e pagueshme prej tij, në përputhje me të cilën një zbritje apo mbajtje e tillë është kërkuar të bëhet, do të rritet në masën e nevojshme për të siguruar që pas bërjes së një zbritjeje apo mbajtjeje, shitësi të marrë dhe të ruajë (pa asnjë detyrim në lidhje me këtë zbritjeje apo mbajtje) një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë dhe ruajtur në rast të moskryerjes së një zbritjeje ose mbajtjeje të tillë.

9.7 Nëse blerësi nuk arrin të paguajë një shumë të pagueshme ndaj shitësit në datën e kërkueshme, blerësi do të paguajë një tarifë pagese të vonuar në lidhje me shumën e kërkueshme dhe të kërkuar nga shitësi, por të papaguar në datën e kërkueshme, që përbëhet si më poshtë:

a) Një shumë e përcaktuar nga shitësi pas aplikimit të formulës së treguar më poshtë:

$$\frac{A \times 1 \% \times B}{360}$$

Ku: "A" nënkupton shumën e papaguar; dhe "B" nënkupton numrin e ditëve nga dhe duke përfshirë këtë datë të kërkueshme, duke përfshirë datën e pagesës aktuale (qoftë para ose pas vendimit).

b) Të gjitha kostot dhe shpenzimet e justifikuar (duke përfshirë pa kufizim çdo kosto dhe shpenzim ligjor ose të mbledhur të agjentit), të shkaktuar nga shitësi si rezultat i vonës në pagesën për shitësin.

9.8 Shitësi paguan çdo shumë të marrë, sipas seksionit 9.7 të kësaj Marrëveshjeje, në llogarinë e Bankës për Zhvillimin Islamik Waqf, pas zbritjes së të gjitha kostove dhe shpenzimeve të shkaktuara nga shitësi.

Neni 10 Përfaqësimet

Blerësi thekson që:

1. Ka kompetencë për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të gjitha veprimet e kërkuara për të vërtetuar se ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe detyrimet nga blerësi janë përmbushur siç duhet.

2. Detyrimet e shprehura për t'u arritur nga blerësi në këtë Marrëveshje janë detyrime ligjore dhe të vlefshme të detyrueshme për blerësin, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

3. Ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga ana e blerësit e detyrimeve të tij nuk përbën dhe nuk do të rezultojë në shkelje të ndonjë marrëveshjeje, traktati ose ligji.

4. Të gjitha aktet, kushtet dhe elementet (duke përfshirë miratimet e kontrollit të shkëmbimit) e kërkuar nga ligjet e Shqipërisë, duhen plotësuar dhe përmbushur, me qëllim që:

i) blerësi të ketë mundësinë që të ketë përgjegjësinë ligjore dhe të përmbushë detyrimet e shprehura për t'u arritur në këtë Marrëveshje;

ii) të sigurojë që detyrimet e shprehura për t'u përmbushur në këtë Marrëveshje të jenë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

iii) ta bëjë këtë Marrëveshje të pranueshme shprehimisht në Shqipëri, pa ndërmarrjen e hapave ose formaliteteve të tjera, të kryera dhe të plotësuara në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Shqipërisë;

5. Të mos ketë filluar apo rrezikuar të fillojë ndonjë veprim apo procedim administrativ nga ose përpara çdo gjykate ose agjencie, e cila mund të ketë ndikim negativ material në gjendjen financiare të blerësit.

6. Sipas ligjeve në fuqi, të Shqipërisë që prej kësaj date, pretendimet e shitësit ndaj blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për ndonjë borxh të blerësit.

Neni 11 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

11.1 Në rast se një prej rasteve të përcaktuara në këtë seksion (rastet e mosplotësimit të detyrimeve) do të ketë ndodhur dhe do të jetë duke ndodhur, atëherë shitësi, me anë të një njoftimi drejtuar blerësit, mund të deklarojë që një pjesë apo i gjithë çmimi i shitjes do të jetë dhe do të bëhet menjëherë i kërkueshëm dhe i pagueshëm (pavarësisht nga ndonjë element i kësaj Marrëveshjeje) pa njoftim të mëtejshëm:

a) mosplotësimi i detyrimeve do të ketë ndodhur në pagesën e ndonjë prej kësteve të çmimit të shitjes dhe ky mosplotësim do të ketë vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

b) mosplotësimi i detyrimeve, i ndryshëm nga mosplotësimi i përcaktuar në pikën (a) më sipër, do të ketë ndodhur në plotësimin e ndonjë detyrimi të blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe një mosplotësim i tillë do të ketë vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

c) çdo përfaqësim ose garanci e konfirmuar ose e bërë nga blerësi në lidhje më ekzekutimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje ose me çdo kërkesë për disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet të jetë i gabuar në aspektin material dhe do të vazhdojë të jetë i gabuar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit të dhënë blerësit nga shitësi;

d) çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme.

11.2 Nëse çdo rast i mosplotësimit të detyrimeve ose çdo rast që me kalimin e kohës ose njoftimit dhe kalimit të kohës do të bëhet një rast i mosplotësimit të detyrimeve, blerësi do t'i japë menjëherë shitësit njoftim për këtë, me teleks ose faks, duke përcaktuar natyrën e këtij rasti të mosplotësimit të detyrimeve ose kësaj ngjarjeje, si dhe hapat që blerësi po ndërmerr për të përmirësuar këtë situatë.

11.3 Asnjë transaksion dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e çdo të drejte, kompetence ose mjeti ligjor që rrjedh prej shitësit në bazë të mosplotësimit të detyrimeve sipas kësaj

Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër nuk do të cenohet këtë të drejtë, kompetencë ose mjet ligjor ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj ose si pranim i heshtur; as veprimi i shitësit në lidhje me një mosplotësim të tillë detyrimesh, ose çdo pranim në heshtje prej tij nuk do të cenohet ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet ligjor të shitësit në lidhje me një mosplotësim tjetër detyrimesh.

Neni 12

Anulimi i shumës së aprovuar

12.1 Nëse kontrata e parë nuk është nënshkruar brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që dokumenti i hollësishëm i planprojektit që përcaktohet në Marrëveshjen e agjencisë, të jetë dorëzuar, shitësi, me anë të një njoftimi drejtuar blerësit, mund të anulohet shumën e aprovuar, nëse nuk është i bindur nga justifikimi i blerësit për këtë vonesë.

12.2 Në rast se një kontraktues nuk përmbush ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kontratës dhe blerësi, në konsultim me shitësin, anulon kontratën në përputhje me kushtet e saj, ky anulim 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas këtij përfundimi do të operohet si anulim i çdo shume të mbetur të padisbursuar nga shuma e aprovuar e kontratës përkatëse, përveç kur shitësi bie dakord ndryshe.

Neni 13

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa dhe nëse blerësi nuk i ka dhënë shitësit një opinion ligjor nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, kryesisht në formën e parashikuar në aneksin III të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14

Përfundimi i Marrëveshjes për moshyrje në fuqi

Nëse Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të saj do të përfundojnë, nëse shitësi, pas shqyrtimit të arsyeve për vonesën, nuk do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij seksioni. Sipas rastit, shitësi do të informojë menjëherë blerësin për këtë datë të mëvonshme ose për përfundimin e Marrëveshjes.

Neni 15

Heqja dorë

Pamundësia e shitësit për të ushtruar ose mbrojtur të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesa apo pamundësia për të ushtruar ose mbrojtur çdo mjet ligjor që mund të ketë ndaj blerësit, nuk do të cenohet këtë të drejtë ose mjet ligjor dhe nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet ligjor.

Neni 16

Ligji rregullues, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

16.1 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit islamik (siç përcaktohet në standardet e Sheriatit të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit e Institucioneve Islamike Financiare dhe siç interpretohet nga Akademia Islamike e Fiqh e Organizatës së Konferencës Islamike ose Komiteti i Sheriatit të IDB-së).

16.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim i njëjës palë ndaj palës tjetër që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, të cilat nuk mund të zgjidhen miqësisht me marrëveshje nga palët brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga njoftimi i njëjës palë për

tjetrën, i nënshtrohet një trupi gjykues arbitrazhi për vendim të formës së prerë dhe detyrues, në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Islamike Ndërkombëtare për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai, në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo pretendim nga një palë ndaj palës tjetër që lind sipas kësaj Marrëveshjeje.

16.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas dorëzimit të kopjeve të vendimit për palët, vendimi nuk është zbatuar, çdo palë mund të fillojë proces gjyqësor ose procedim për zbatimin e vendimit pranë një gjykate të juridiksionit kompetent kundër palës tjetër, mund të zbatojë këtë vendim me anë të ekzekutimit ose të përdorë ndonjë mjet tjetër ligjor të përshtatshëm kundër palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

16.4 Çdo palë merr përsipër të ekzekutojë një vendim të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17 Njoftimet

17.1 Çdo njoftim ose kërkesë që duhet të jepet ose të bëhet nga njëra palë për tjetrën, sipas kësaj Marrëveshjeje ose në lidhje me të, do të bëhet me shkrim dhe mund të jepet me faks ose shkresë. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të vlerësohet të jetë dhënë rregullisht nëse dorëzohet dorazi ose me postë ose dërgohet me faks për palën tjetër në adresën e saj të përcaktuar në seksionin 17.2 të kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë adresë tjetër që mund të përcaktojë me njoftim për palën tjetër.

17.2 Për qëllimet e seksionit 17.1 të kësaj Marrëveshjeje, palët kanë dhënë adresat e tyre si më poshtë:

Për blerësin:
Ministria e Financave
Bulevardi: Dëshmorët e Kombit, nr. 1
Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 228 405
Faks: +355 4 228494

Për shitësin:
P.O.Box 5925
Jeddah 21432
Kingdom of Saudi Arabia
Tel: +966 2 636 1400
Faks: +966 2 6366871

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë marrëveshje në datën e përmendur në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCA I PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Projekti synon në rindërtimin e rreth 173 km të rrugëve dytësore dhe lokale në veri të Shqipërisë që përbëjnë pjesën e financuar nga IDB-ja nga një program me shumë financime për përmirësimin e përgjithshëm të rreth 1500 km të rrugëve dytësore dhe rurale në Shqipëri.

Për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të këtij rrjeti dhe kufizimeve në planprojektet fillestare të këtyre rrugëve, ndërhyrjet sipas këtij projekti priten të jenë ose rehabilitimi ose rindërtimi (duke përfshirë strukturat e urave).

Rrugët dytësore (rajonale) duhet të rindërtohen me një rrugë transporti të shtruar me 2 korsi me gjerësi nga 6.0 deri në 7.5 metra, me, përkatësisht, një segment anësor të shtruar në secilën anë midis 0.5 dhe 1.5 metra. Në zonat urbane, rrugët për këmbësorët të shtruara (min 1,0 m) duhet të zëvendësohen me segmente anësore, nëse të dyja nuk mund të përshtaten. Kur është e nevojshme, do të përfshihet edhe infrastruktura e sigurisë rrugore.

Rrugët lokale duhet të rindërtohen me një rrugë transporti të shtruar me një korsi prej 3.5 metra dhe 1.0 metër segmente anësore të shtruara në secilën anë për rrugët e tipit L1, segmente anësore të shtruara 3.25 metra dhe 0.75 metra në secilën anë për rrugët e tipit L2 dhe segmente anësore të shtruara 3.0 metra dhe 0.5 metër në secilën anë për rrugët e tipit L3.

Për më tepër, rrugët do të përfshijnë pragje 0.5 m në secilën anë të strukturës së asfaltit.

SHTOJCA II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe zbutja e varfërisë për banorët në zona të largëta të rrugëve të përmirësuara, duke u siguruar atyre akses në shërbimet bazë, si dhe mundësi ekonomike. Projekti lidh qendrat e popullsisë rurale dhe kontribuon gjithashtu në forcimin e kuadrit institucional për planifikimin, financimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri.

Përfshirja e IDB-së në projekt synon të mbulojë rindërtimin e disa segmenteve rrugore, gjatësia e përgjithshme e të cilave është rreth 173 km dhe numri i përfituesve është afërsisht 127,000.

Objekti i projektit mbulon:

- A. Punimet civile;
- B. Konsulencën e hollësishme të planprojektit;
- C. Konsulencën e mbikëqyrjes;
- D. Menaxhimin e projektit;
- E. Trajnimin e njësive të qeverisë lokale për mirëmbajtje;
- F. Auditimin financiar;
- G. Seminarin fillestar të projektit dhe vizitat njohëse në IDB/HQ.

Financimi i “ISTISNA’A” i IDB-së do të përdoret për komponentin e punimeve civile të projektit.

SHTOJCA III
FORMA E OPINIONIT TË MINISTRIT TË DREJTËSISË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(BLERËSI)

Datë ____ / ____ / ____

Banka Islamike për Zhvillim
P.O.Box: 5925
Jeddah 21432
Kingdom of Saudi Arabia

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë (“blerësi”), kam shqyrtuar origjinalet (ose kopjet) e vërtetuara ose të identifikuara sipas pëlqimit tim, të Marrëveshjes ISTISNA’A dhe Marrëveshjes së agjencisë të datës ____ / ____ / ____ (“marrëveshjet”) që parashikojnë projektin për financimin dhe rindërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri (punimet) nga Banka Islamike për Zhvillim (Shitësi) për blerësin, në një shumë prej 30 000 000 USD (tridhjetë milionë dollarë amerikanë), dhe duke caktuar blerësin si agjentin e shitësit për mbikëqyrjen e punimeve dhe shitjen për blerësin dhe çdo dokument tjetër që e kam konsideruar të nevojshëm ose të përshtatshëm si bazë për opinionet e shprehura në këtë Marrëveshje.

Opinionet e shprehura në këtë Marrëveshje kufizohen në çështjet që lindin sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe nënndarjeve të saj politike dhe unë nuk synoj të shpreh opinion mbi ndonjë çështje që lind sipas ligjit të një juridiksioni tjetër.

Të gjitha termat e përcaktuara në Marrëveshje dhe të përdorura, por të papërkufizuara në të, kanë kuptimet e dhëna për to në Marrëveshje.

Sa më sipër, opinionimi im është se:

a) Blerësi ka kompetencën dhe autoritetin për të zotëruar pronën e tij, për të zhvilluar biznesin e tij, siç po e zhvillon aktualisht, dhe për të kryer transaksionet e parashikuara në Marrëveshje.

b) Blerësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të konfirmuar ekzekutimin dhe dorëzimin e marrëveshjeve dhe të gjitha dokumentet e tjera që duhet të ekzekutohen dhe dërgohen nga ai në lidhje me Marrëveshjen, përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjeve dhe kryerjen e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshje.

c) Marrëveshjet janë ekzekutuar dhe dorëzuar rregullisht nga blerësi dhe përbëjnë detyrime të ligjshme, të vlefshme dhe të detyrueshme për blerësin, të zbatueshme për blerësin, në përputhje me kushtet e tyre, në bazë të paaftësisë së zbatueshme paguese, moratoriumit dhe ligjeve të ngjashme që cenojnë përgjithësisht të drejtat e kreditorëve.

d) Të gjitha autorizimet qeveritare dhe masat e çdo lloji, të nevojshme për të konfirmuar ose kërkuar vlefshmërinë dhe vendosjen e detyrimeve të parashikuara sipas këtyre marrëveshjeve kundrejt blerësit, janë marrë ose realizuar dhe janë të vlefshme me fuqi dhe efekt të plotë.

e) Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon që, përbën, ose që, me dhënien e njoftimit ose me kalimin e kohës ose me të dyja bashkë, do të përbënte një mosplotësim detyrimesh sipas çdo marrëveshjeje ose instrumenti që përcakton çdo detyrim të Blerësit, dhe asnjë ngjarje e tillë nuk do të ndodhë pas kryerjes së ndonjë disbursimi sipas Marrëveshjes.

f) Çdo kreditori të blerësit nuk i kërkohet miratim ose njoftim sipas kushteve të ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti që identifikon çdo detyrim të blerësit për ekzekutimin ose dorëzimin, ose përmbushjen e detyrimeve të blerësit sipas marrëveshjeve, ose kryerjen e transaksioneve të parashikuara në Marrëveshje dhe se ekzekutimi, dorëzimi, përmbushja e detyrimeve dhe kryerja e transaksioneve nuk do të rezultojë në ndonjë shkelje ose kundërvajtje ose nuk do të përbëjë një mosplotësim detyrimesh sipas kartës ose akteve nënligjore të blerësit ose çdo marrëveshjeje, instrumenti, vendimi apo urdhri të njohur prej meje, apo çdo statuti, rregulli apo rregulloreje të zbatueshme për blerësin apo për një pjesë të pasurisë së tij.

g) Nuk ka veprime apo procedime të lëna pezull apo, sipas informacionit tim, të pritshme përcaktimi i gabuar i të cilëve mund të kishte një ndikim materialisht negativ në situatën financiare të blerësit apo të cenojnë aftësinë e blerësit për të përmbushur detyrimet e tij apo të cenojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e Marrëveshjeve.

h) Blerësi ka titull të plotë mbi pronën e tij pa asnjë detyrim garancie dhe barra të tjera dhe detyrimet e tij sipas Marrëveshjes renditen të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara.

i) Ekzekutimi dhe dorëzimi i marrëveshjeve nuk janë subjekt i ndonjë takse, tatimi, tarife apo detyrimi tjetër, duke përfshirë pa kufizim çdo taksë regjistrimi ose transferimi apo pagesë për vulën apo detyrime të ngjashme të vendosura nga ose brenda Shqipërisë ose ndonjë nënndarjeje politike ose autoriteti tatimor të saj ose në të.

j) Blerësi heq dorë nga imuniteti i tij për arsye të juridiksionit në lidhje me çdo padi ose procedim që lidhet në ndonjë mënyrë me Marrëveshjen që mund të paraqitet në gjykatat e Shqipërisë.

k) Ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes nga blerësi dhe përmbushja e detyrimeve të tij sipas saj përbëjnë transaksione tregtare.

l) Zgjedhja nga palët e marrëveshjeve të parimeve të Sheriatit Islamik si ligj rregullues është e ligjshme, e vlefshme dhe detyruese.

m) Nuk është e nevojshme të sigurohet që ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria apo pranueshmëria e qartë në gjykatat e Shqipërisë, e marrëveshjeve që ato të paraqiten, shënohen, regjistrohen ose depozitohen në çdo gjykatë apo agjenci qeveritare ose në Shqipëri ose të vulosen me ndonjë vulë apo taksë transaksioni të ngjashëm.

n) Nuk është e nevojshme sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Shqipërisë për t'i dhënë mundësinë shitësit të zbatojë të drejtat e tij sipas Marrëveshjeve ose për shkak të ekzekutimit të Marrëveshjeve apo përmbushjes nga ana e shitësit të detyrimeve të tij sipas Marrëveshjeve që shitësi duhet të jetë i licencuar, i kualifikuar ose i autorizuar për të zhvilluar biznes në Shqipëri.

o) Shitësi nuk konsiderohet të jetë rezident, me banim të përhershëm për të zhvilluar biznes apo subjekt i tatimit në Shqipëri vetëm për shkak të ekzekutimit, përmbushjes dhe/ose zbatimit të Marrëveshjeve, kryerjen e punimeve nga shitësi dhe shitjen e tyre për blerësin sipas Marrëveshjeve, dhe nuk do të mbahen taksa në çdo shumë që mund të merret nga shitësi sipas Marrëveshjeve.

Derisa dhe nëse nuk i jap shitësit njoftim në lidhje me ndonjë ndryshim në këtë opinion para disbursimit të fondeve sipas Marrëveshjes, ju dhe përfaqësuesi juaj ligjor mund të mbështeteni në këtë opinion në çdo kohë që prej kësaj date dhe duke përfshirë një disbursim të tillë, sikur ky opinion të mbante atë datë dhe të dorëzohej në atë kohë.

Me respekt

MARRËVESHJE E AGJENCISË “ISTISNA’A”
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM MBI
PROJEKTIN E RINDËRTIMIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE

Kjo Marrëveshje është lidhur më .../.../...1431 H (që i korrespondon .../.../...2010G) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur “agjenti”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim e quajtur “IDB”).

Agjenti dhe IDB-së referohen këtu veçmas si “pala” dhe bashkërisht si “palët”.

Duke marrë në konsideratë se:

1. IDB-ja ka rënë dakord në përputhje me marrëveshjen e kësaj date (në vijim e quajtur Marrëveshja “ISTISNA’A”) për të kryer për agjentin punimet e përshkruara në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje (në vijim të quajtura “punimet”) për përdorim në projektin e përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje.

2. IDB-ja ka rënë dakord me agjentin që ky i fundit, në emër të IDB-së, të lidhë kontratën me kontraktuesin dhe të mbikëqyrë kryerjen e punimeve.

3. Palët kanë rënë dakord që agjencia zbatuese përgjegjëse për zbatimin e projektit në emër të agjentit do të jetë Fondi i Zhvillimit Shqiptar.

Rrjedhimisht IDB-ja dhe agjenti bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime, interpretimi

1.1 Në këtë Marrëveshje, përveçse kur konteksti kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin që shfaqet përbri secilit prej tyre si më poshtë:

Shuma e aprovuar: Shuma e aprovuar nga IDB-ja për kryerjen e punimeve.

Kostoja e kapitalit: Kostoja totale e kryerjes së punimeve, e cila përfshin çmimin e kontratës, tarifat e konsulentit dhe çdo kosto apo shpenzim tjetër që shkaktohet nga IDB-ja në apo në lidhje me kryerjen e punimeve dhe mbikëqyrjen e ndërtimit.

Konsulenti i planprojektit: Subjekti/personi të cilit i besohet përgatitja e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimet teknike, vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e rrugëve përkatëse.

Konsulenti i mbikëqyrjes: Subjekti/personi të cilit i besohet mbikëqyrja e punimeve.

Koordinatori i projektit: Personi përgjegjës për bashkërendimin e implementimit të komponentëve të financuar të IDB-së të projektit, me të gjitha palët e përfshira në implementim.

Dokumenti i hollësishëm i planprojektit: Dokumenti që mbulon përgatitjen e të gjitha skicave të hollësishme, specifikimeve teknike, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe preventivat që nevojiten për ndërtimin e projektit.

Çmimi i kontratës: Çmimi i pagueshëm për kontraktuesin për kryerjen e punimeve ose një pjesë të tyre, në përputhje me kontratën.

Kontrata: Kontrata për kryerjen e punimeve ose ndonjë pjesë të tyre, e lidhur në emër të IDB-së nga agjenti me kontraktuesin.

Kontrata e parë: Kontrata e parë e lidhur për përfundimin e një pjese të punimeve, nga blerësi në emër të shitësit, me kontraktuesin përkatës.

Kontraktuesi: Shoqëria së cilës i besohet kryerja e punimeve ose ndonjë pjese të tyre, ose çdo kontraktues tjetër që mund të angazhohet për këtë qëllim.

Data e disbursimit të parë: Data në të cilën IDB-ja bën disbursimin e parë sipas kontratës.

Disbursimi: Çdo pagesë e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje ose kontrate.

Data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes: Data në të cilën IDB-ja e shpall këtë Marrëveshje në fuqi, në përputhje me nenin 12 të saj.

Certifikata përfundimtare e pranimit: Certifikata e lëshuar nga konsulenti i mbikëqyrjes në përputhje me kushtet e kontratës dhe e sigluar nga agjenti, i cili përcakton se kryerja e punimeve ose ndonjë pjesë e tyre është realizuar në mënyrë të kënaqshme nga kontraktuesi.

Periodha e maturimit: Periodha që fillon në datën e disbursimit të parë dhe përfundon dyzet e tetë (48) muaj më pas.

Certifikata e pranimit paraprak: Certifikata e lëshuar nga konsulenti i mbikëqyrjes sipas kontratës dhe e sigluar nga agjenti, e cila përcakton pranimin paraprak të punimeve ose ndonjë pjesë e tyre nga agjenti, siç tregohet në kontratë.

Projekti: Projekti i përshkruar në shtojcën II të kësaj Marrëveshjeje.

Taksa: Çdo taksë, detyrim, tatim ose çdo tarifë tjetër e një natyre të ngjashme (duke përfshirë pa kufizim çdo gjobë të pagueshme në lidhje me çdo pamundësi për të paguar ose vonesë në pagesën e sa më sipër).

Punime: Punime ose pjesë të tyre të përshkruara në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje dhe në çdo kontratë përkatëse.

1.2 Në këtë Marrëveshje:

a) Përveç kur konteksti kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës, përfshijnë edhe numrin e shumës dhe anasjelltas, fjalët që shprehin persona përfshijnë korporatat dhe partneritetet; dhe referencat ndaj një shtojce, neni apo seksioni të specifikuar janë referenca ndaj një shtojce, neni ose seksioni të kësaj Marrëveshjeje;

b) Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshjen “ISTISNA’A” dhe që nuk janë përcaktuar këtu, do të kenë të njëjtin kuptim siç është dhënë në Marrëveshjen “ISTISNA’A”;

c) Titujt e neneve dhe seksioneve janë vendosur vetëm për lehtësi reference dhe nuk do të përdoren për të përkufizuar, interpretuar apo kufizuar ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Preambula dhe shtojcat, pjesë e Marrëveshjes

Preambula dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë përbërëse e saj.

Neni 3

Zgjedhja e kontraktuesit

3.1 Palët e kësaj Marrëveshjeje kanë rënë dakord që agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, në konsultim me IDB-në dhe në përputhje me procedura e prokurimit të IDB-së, si dhe në bazë të miratimit të saj, të prokurorë kontrata për ekzekutimin e projektit, bazuar në sa më poshtë:

“Kontraktuesit e punimeve civile do të përzgjidhen nëpërmjet ofertimit konkurrues kombëtar (OKK) të kryer nga agjenti nëpërmjet agjencisë zbatuese, nga kontraktues të kualifikuar për kryerjen e punimeve në përputhje me procedurat e prokurimit të IDB-së.”

3.2 Agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, në emër të IDB-së, do të negociojë dhe lidhë një kontratë me kontraktuesin sa më poshtë:

a) Termat dhe kushtet e kontratës do të bien dakord ndërmjet IDB-së dhe agjentit.

b) Kontributi i IDB-së në çmimin e kontratës nuk do të kalojë 30 000 000 USD (tridhjetë milionë dollarë amerikanë).

c) Periodha për përfundimin e kryerjes së punimeve sipas kontratës nuk do të kalojë dyzet e tetë (48) muaj nga data e disbursimit të parë.

d) Specifikimet e punimeve sipas kontratës do të jenë si ato që përshkruhen shkurtimisht në shtojcën I të kësaj Marrëveshjeje dhe siç tregohen hollësisht në kontratë.

e) Miratimi me shkrim i IDB-së për termat dhe kushtet e kontratës së negociuar ose çdo amendim të saj do të merret para lidhjes së kontratës nga agjenti i kontratës ose ndonjë shtesë të saj.

f) Pas përfundimit, punimet do të merren në dorëzim drejtpërdrejt nga agjenti nëpërmjet agjencisë ekzekutuese.

g) Kontrata do të përcaktojë se kontraktuesi do të prokurojë të gjithë sigurimin e rrezikut të kontraktuesit sipas rregullave të tregtisë dhe shumat e sigurimit do t'i paguhen IDB-së në dollarë amerikanë.

Neni 4

Ndryshimet dhe amendimet e kontratës

Agjenti, pa miratimin paraprak me shkrim të IDB-së, nuk do të bëjë asnjë amendim, ndryshim ose modifikim të kontratës që: (a) mund të rezultojë në rritje të çmimit të kontratës ose (b) në një shtyrje të datës së përfundimit, ose (c) në një ndryshim të specifikimit, ose (d) mos jetë në përputhje me praktikën e mirë të zakonshme.

Neni 5

Koordinimi i projektit dhe caktimi i konsulentëve

5.1 IDB-ja dhe agjenti kanë rënë dakord për përzgjedhjen e konsulentit të planprojektit, në përputhje me procedurat dhe udhëzimet e IDB-së.

5.2 Konsulenti i mbikëqyrjes mbikëqyr aktivitetet e ndërtimit për të siguruar që punimet janë kryer sipas skicave të projektit dhe specifikimeve të miratuara dhe gjithashtu i jep raporte të rregullta agjencisë zbatuese.

5.3 Koordinatori i projektit përzgjidhet nga agjencia zbatuese dhe miratohet nga IDB. Koordinatori i projektit është përgjegjës për të garantuar që të gjitha procedurat dhe udhëzimet e IDB-së janë ndjekur rreptësisht gjatë të gjithë periudhës së kryerjes së punimeve.

5.4 Termet e referencës së konsulentit të planprojektit bien dakord me agjentin.

5.5 Agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, merr përsipër që gjatë menaxhimit të projektit, ai do të ushtrojë standardin më të lartë të maturisë dhe kujdesit në monitorimin, me ndihmesën e koordinatorit të projektit dhe konsulentit të mbikëqyrjes, e përmbushjes së duhur dhe të saktë nga ana e kontraktuesit të detyrimeve të tij sipas kontratës, me synimin për të siguruar që punimet do të kryen në përputhje me specifikimet brenda afatit dhe për çmimin e përcaktuar në kontratë.

5.6 Pa cenuar përgjithësimin e seksionit 5.5 të kësaj Marrëveshjeje, agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, do të jetë i detyruar:

a) të këshillojë IDB-në, sa më shpejt që të jetë e mundur, mbi çdo vonesë apo vonesë të pritshme në përfundimin e kryerjes së punimeve me të gjitha hollësitë përkatëse;

b) të merret me të gjitha çështjet rregullatore dhe administrative në lidhje me kryerjen e punimeve, në përputhje me ligjet përkatëse në Shqipëri;

c) të nënshkruajë certifikatën e pranimit paraprak dhe certifikatën e pranimit përfundimtar nëse ai është i bindur se punimet në fazën përkatëse janë kryer në përputhje me kontratën, duke përfshirë specifikimet.

5.7 Nëse, në shkelje të nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje, agjenti jep udhëzime për kontraktuesin, si rrjedhojë e të cilave ka një rritje të çmimit të kontratës apo IDB-së bëhet përgjegjëse ndaj çdo pale për ndonjë pretendim, humbje, dëm apo shpenzim, atëherë agjenti bie dakord që të përballojë rritjen në çmimin e kontratës ose, sipas rastit, të dëmshpërblejë IDB-në për çdo pretendim, humbje, dëm apo shpenzim të tillë.

5.8 Është rënë dakord që agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, të sigurojë një numër të tillë të personelit të tij që do të ishte i nevojshëm për të përmbushur detyrat e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe kontratës.

5.9 Agjenti nuk ka të drejtë për asnjë shpërblim apo pagesë tjetër nga IDB-ja në lidhje me apo që rrjedh nga caktimi i tij si agjent sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Disbursimi i shumës së aprovuar

6.1 IDB-ja do të disbursojë shumën e aprovuar në mënyrën e përcaktuar në kontratë dhe në përputhje me procedurat e disbursimit të IDB-së.

6.2 Data e kërkesës së disbursimit të parë: Nëse brenda 180 ditësh nga data e hyrjes në fuqi, me kusht që të jetë dorëzuar dokumenti i hollësishëm i planprojektit ose në një datë të mëvonshme që do të bihet dakord ndërmjet IDB-së dhe agjentit, ky i fundit, nëpërmjet agjencisë zbatuese, nuk ka paraqitur një kërkesë për disbursimin e parë, IDB-ja mund të anulojë këtë Marrëveshje, pas dhënies së njoftimit të duhur për agjentin.

6.3 Data e përfundimit të disbursimit: Data 31.3.2014, ose një datë e mëvonshme që do të bihet dakord ndërmjet IDB-së dhe agjentit, do të jetë data e përfundimit të tërheqjes sipas kësaj Marrëveshjeje.

6.4 Pa cenuar përgjithësimin e seksionit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje, agjenti, pas paraqitjes së kërkesës për disbursimin e parë sipas kontratës, do të dorëzojë një kopje të firmosur të kontratës (nëse është paraqitur më parë) dhe kopje të policës së sigurimit të përmendur në seksionin 3.2 (g) të kësaj Marrëveshjeje.

6.5 IDB-ja nuk është e detyruar të kryejë ndonjë disbursim sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse kërkesa për disbursim nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje ose nëse dokumentet e paraqitura nga agjenti janë të paplota ose me mangësi të tjera. Agjenti është përgjegjës për çdo vonesë në kryerjen e disbursimit nëse kjo vonesë ndodh për shkak se kërkesa nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje ose për shkak të pamjaftueshmërisë ose mospërputhjes në dokumentet e kërkuara.

Neni 7
Marrja në dorëzim e punimeve

7.1 Është rënë dakord që kontrata do të parashikojë për marrjen në dorëzim të punimeve pas përfundimit nga agjenti nëpërmjet agjencisë zbatuese. Gjithashtu, është rënë dakord që IDB-ja nuk do të jetë në asnjë rast përgjegjëse për agjentin për çfarëdo humbje që rezultojnë nga çdo vonesë në marrjen në dorëzim të punimeve.

7.2 Për shmangien e çdo dyshimi, është rënë dakord që, nëse pas nënshkrimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, agjenti refuzon të marrë në dorëzim punimet nga kontraktuesi për çfarëdolloj arsyeje, agjenti do të dëmshpërblejë IDB-në për çdo kosto, shpenzim apo humbje që ka rezultuar nga më sipër.

Neni 8
Përfaqësimet dhe garancitë

Agjenti përfaqëson dhe garanton se:

1. Ka kompetencën për të hyrë në këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tij të sipas saj dhe të gjitha veprimet e kërkuara për të siguruar ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga agjenti e detyrimeve të tij janë kryer siç duhet;

2. Detyrimet e shprehura për t'u marrë përsipër nga agjenti në këtë Marrëveshje janë të vlefshme dhe të ligjshme, detyruese për agjentin në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje;

3. Ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga agjenti e detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate nuk përbëjnë e nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje të një marrëveshjeje, traktati apo ligji;

4. Të gjitha aktet, kushtet dhe elementet (duke përfshirë shkëmbimin e miratimeve të kontrollit) të kërkuara nga ligjet e Shqipërisë do të bëhen, plotësohen dhe kryhen me qëllim që:

i) agjenti të ketë mundësinë që të ketë përgjegjësinë ligjore dhe të përmbushë detyrimet e shprehura për t'u arritur nga ai në këtë Marrëveshje;

ii) të sigurojë që detyrimet e shprehura për t'u përmbushur nga ai në këtë Marrëveshje të jenë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme; dhe

iii) ta bëjë këtë Marrëveshje të pranueshme shprehimisht në Shqipëri, pa ndërmarrjen e hapave ose formaliteteve të tjera, të kryera dhe të plotësuara në përputhje të plotë me ligjet dhe Kushtetutën e Shqipërisë.

5. Të mos ketë filluar apo rrezikuar të fillojë ndonjë veprim apo procedim administrativ nga ose përpara çdo gjykate ose agjencie, e cila mund të ketë ndikim negativ material në gjendjen financiare të blerësit.

6. Sipas ligjeve të Shqipërisë në fuqi që prej kësaj date, pretendimet e IDB-së ndaj agjentit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tjerë të pasiguruar për ndonjë borxh të agjentit.

Neni 9

Dëmshpërblimet

9.1 Me anë të kësaj Marrëveshjeje, agjenti merr përsipër të dëmshpërblejë IDB-në, mbi bazën e një shume të llogaritur neto pas taksave (në normat e zbatueshme të taksave mbi të ardhurat lokale dhe të huaja) dhe bie dakord të mbrojë, ruajë dhe mos dëmtojë IDB-në nga ndonjë dhe të gjitha detyrimet, tarifrat, përgjegjësitë, humbjet, dëmet, gjobat, kërkesat, veprimet, gjykimet dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifa dhe shpenzime të arsyeshme ligjore (përfshirë tarifa dhe shpenzime të tilla ligjore të shkaktuara në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje) të çdo lloji dhe natyre qofshin, të vendosura mbi apo të shkaktuara nga apo të pretenduara kundër IDB-së e që rrjedhin nga:

a) pronësia, zotërimi, përdorimi, dokumentimi, heqja, kthimi apo aplikime, apo kushte të tjera sipas kontratës, duke përfshirë elemente që mund të lindin nga:

i) çdo lloj humbje apo dëmi ndaj çdo pasurie apo vdekjeje, apo plagosjeje të ndonjë personi;

ii) mangësi evidente apo të fshehura në punime;

iii) çdo pretendim të bazuar në përgjegjësinë e kufizuar në dëm apo ndryshe;

iv) çdo pretendim të bazuar në shkelje të të drejtave të autorit, markave tregtare ose patentave;

v) çdo pretendim që bazohet në përgjegjësinë që lind sipas ligjeve të zbatueshme mjedisore apo miratimet mjedisore;

vi) çdo pretendim në lidhje me të drejtat mbi punimet apo truallin mbi të cilin ato kryhen;

vii) çdo pretendim apo mosmarrëveshje që lidhet me kontratën apo çdo letër krediti e lëshuar sipas saj.

b) mospagesa apo çdo pamundësi tjetër nga ana e agjentit apo e kontraktuesit për të përmbushur apo respektuar çdo afat të kësaj Marrëveshjeje apo çdo dokument, marrëveshjeje apo kontratë të lidhur në lidhje me të apo ndryshe në lidhje me punimet, por duke përjashtuar çdo pretendim të bazuar në pamundësinë nga ana e IDB-së për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo çdo dokumenti, marrëveshjeje apo kontrate të lidhur nga IDB-ja në lidhje me të apo ndryshe në lidhje me punimet;

c) çdo pretendim, barrë, interes sigurimi dhe detyrime garancie apo procese gjyqësore në lidhje me të drejtat apo interesat mbi punimet apo truallin mbi të cilin ato kryhen.

9.2 Agjenti, nëpërmjet agjencisë zbatuese, do t'i japë IDB-së njoftim të menjëhershëm mbi çdo ndodhi apo situatë të njohur për agjentin si pasojë e të cilit IDB-ja ka apo mund të ketë të drejtë për dëmshpërblim. Dëmshpërblimi i parashikuar në seksionin 9.1 do të zbatohet specifikisht dhe do të përfshijë pretendimet apo paditë e ngritura nga apo në emër të punonjësve të agjentit dhe agjenti heq dorë shprehimisht, kundër IDB-së, nga çdo imunitet ndaj të cilit agjenti mund të kishte pasur ndryshe të drejtë sipas ligjeve të zbatueshme. Agjenti do të rimbursojë menjëherë IDB-në, sipas kërkesës së IDB-së (por në çdo rast, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga kjo kërkesë) për shumën e shpenzuar nga ai në lidhje me cilëndo nga sa më sipër ose t'i paguajë këto shuma drejtpërdrejt. Agjenti do të zëvendësojë të drejtat e IDB-së në çdo çështje, në lidhje me të cilën agjenti e ka rimbursuar IDB-në për shumën e shpenzuar nga ajo apo ka paguar drejtpërdrejt shumën e tilla në përputhje me seksionin 9.1. Në rast se ngrihet ndonjë padi apo procedim kundër IDB-së në lidhje me ndonjë pretendim të padëmshpërblës, IDB-ja do të njoftojë për këtë agjentin, pas marrjes së

njoftimit mbi fillimin e një padie apo procedimi të tillë, duke i bashkëlidhur një kopje të të gjitha dokumenteve që i janë dërguar IDB-së. Sipas kërkesës së IDB-së, agjenti mund të mbrohet nga dhe të kundërshtojë një padi apo procedim të tillë me shpenzimet e tij apo të bëjë që kjo mbrojtje apo kundërshtim të bëhet nga një avokat i zgjedhur nga agjenti dhe në mënyrë të arsyeshme i pranueshëm për IDB-në. Në rast të ndonjë pamundësie nga agjenti për të vepruar kështu, agjenti do të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të avokatit) të shkaktuar nga IDB-ja në lidhje me këtë padi apo procedim.

Neni 10 **Raportet**

Agjenti merr përsipër të sigurojë paraqitjen pranë IDB-së, me pëlqimin e plotë të kësaj të fundit dhe në momentet e përcaktuara për secilën, raportet e mëposhtme:

i) Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të çdo semestri kalendarik ose brenda një periudhe tjetër për të cilën palët mund të bien dakord, raporte mbi ekzekutimin e projektit, në atë mënyrë që IDB mund të caktojë herë pas here;

ii) Raporte të tjera që IDB-ja mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, herë pas here, në lidhje me progresin e projektit;

iii) Menjëherë pas lëshimit të certifikatës së pranimit përfundimtar, por jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të kësaj certifikate ose në një datë të mëvonshme për të cilën mund të bihet dakord për këtë qëllim ndërmjet agjentit dhe i IDB-së, agjenti do të përgatisë dhe dorëzojë pranë IDB-së një raport përfundimtar për një qëllim të tillë dhe me hollësi të tilla që IDB-ja mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme mbi ekzekutimin dhe operimin fillestar të projektit.

Neni 11 **Heqja dorë**

Pamundësia e IDB-së për të ushtruar apo mbështetur ndonjë nga të drejtat e saj sipas kësaj marrëveshjeje apo vonesa e saj për këtë, apo pamundësia e saj për të ushtruar apo mbështetur çdo mjet ligjor që ajo mund të ketë kundër agjentit apo vonesa e saj për këtë, nuk cenon këtë të drejtë apo mjet ligjor dhe nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë apo mjet ligjor.

Neni 12 **Data e hyrjes në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes “ISTISNA’A”.

Neni 13 **Ligji rregullues, zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

13.1 Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me parimet e Sheriatit Islamik (siç përcaktohet në standardet e Sheriatit të publikuara nga Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit e Institucioneve Financiare Islamike dhe siç interpretohet nga Akademia Islamike Fiqh e Organizatës së Konferencës Islamike ose Komiteti i Sheriatit të IDB-së).

13.2 Çdo marrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga një palë kundër palës tjetër që lind nga kjo Marrëveshjeje, i cili nuk mund të zgjidhet miqësisht me marrëveshje ndërmjet palëve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh njoftimi nga një palë për tjetrën, do t’i paraqitet një trupi gjykues arbitrazhi për vendim të formës së prerë dhe detyrues, në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islamike për Pajtim dhe Arbitrazh (IICRA), Dubai në Emiratet e Bashkuara Arabe. Rregullat dhe procedurat e arbitrazhit të IICRA-s do të zëvendësojnë çdo procedurë tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo pretendim nga një palë kundër palës tjetër që lind sipas kësaj Marrëveshjeje.

13.3 Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas dorëzimit ndaj palëve të kopjeve të vendimit, vendimi nuk është zbatuar, çdo palë mund të fillojë një proces gjyqësor ose procedim për zbatimin e vendimit në çdo gjykatë të juridiksionit kompetent kundër palës tjetër, mund të zbatojë këtë vendim me anë të ekzekutimit ose mund të përdorë çdo mjet tjetër ligjor të përshtatshëm kundër palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

13.4 Çdo palë merr përsipër që të ekzekutojë çdo vendim apo gjykim të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14 Njoftimet

14.1 Çdo njoftim ose kërkesë që duhet të jepet ose të bëhet nga një palë për tjetrën sipas kësaj Marrëveshjeje apo në lidhje me të, do të jetë me shkrim dhe mund të jepet me faks ose shkresë. Një njoftim ose kërkesë e tillë do të vlerësohet se është dhënë apo bërë sipas rregullave kur të jetë dërguar dorazi ose përmes postës apo të jetë dërguar me faks për palën tjetër në adresën e përcaktuar në seksionin 14.2 të kësaj Marrëveshjeje apo në çdo adresë tjetër që mund të përcaktojë me njoftim për palën tjetër.

14.2 Për qëllimet e seksionit 14.1 të kësaj Marrëveshjeje, palët kanë dhënë adresat e tyre si më poshtë:

Për agjentin:
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1
Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 228 405
Faks: +355 4 228 494

Për IDB-në
P.O.Box: 5925,
Jeddah – 21432
Kingdom of Saudi Arabia
Faks: +966 2 636 6871
Tel: +966 2 636 1400

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e përmendur në preambulën e kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCA I PËRSHKRIMI I PUNIMEVE

Projekti synon rindërtimin e rreth 173 km të rrugëve dytësore dhe lokale në veri të Shqipërisë që përbëjnë pjesën e financuar nga IDB-ja nga një program me shumë financime për përmirësimin e përgjithshëm të rreth 1500 km të rrugëve dytësore dhe rurale në Shqipëri.

Për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të këtij rrjeti dhe kufizimeve në planprojektet fillestare të këtyre rrugëve, ndërhyrjet sipas këtij projekti priten të jenë ose rehabilitimi, ose rindërtimi (duke përfshirë strukturat e urave).

Rrugët dytësore (rajonale) duhet të rindërtohen me një rrugë transporti të shtruar me 2 korsi me gjerësi nga 6.0 deri në 7.5 metra, me, përkatësisht, një segment anësor të shtruar në secilën anë midis 0.5 dhe 1.5 metra. Në zonat urbane, rrugët për këmbësorët, të shtruara (min 1.0 m), duhet të zëvendësohen me segmente anësore, nëse të dyja nuk mund të përshtaten. Kur është e nevojshme, do të përfshihet edhe infrastruktura e sigurisë rrugore.

Rrugët lokale duhet të rindërtohen me një rrugë transporti të shtruar me një korsi prej 3.5 metra dhe 1.0 metër segmente anësore të shtruara në secilën anë për rrugët e tipit LI, segmente

anësore të shtruara 3.25 metra dhe 0.75 metra në secilën anë për rrugët e tipit L2 dhe segmente anësore të shtruara 3.0 metra dhe 0.5 metër në secilën anë për rrugët e tipit L3. Për më tepër, rrugët do të përfshijnë pragje 0.5 m në secilën anë të strukturës së asfaltit.

SHTOJCA II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe zbutja e varfërisë për banorët në zona të largëta të rrugëve të përmirësuara, duke u siguruar atyre akses në shërbimet bazë, si dhe mundësi ekonomike. Projekti lidh qendrat e popullsisë rurale dhe kontribuon gjithashtu në forcimin e kuadrit institucional për planifikimin, financimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri.

Përfshirja e IDB-së në projekt synon të mbulojë rindërtimin e disa segmenteve rrugore, gjatësia e përgjithshme e të cilave është rreth 173 km dhe numri i përfituesve është afërsisht 127 000.

Objekti i projektit mbulon:

- A. Punimet civile;
- B. Konsulencën e hollësishme të planprojektit;
- C. Konsulencën e mbikëqyrjes;
- D. Menaxhimin e projektit;
- E. Trajnimin e njërive të qeverisë lokale për mirëmbajtje;
- F. Auditimin financiar;
- G. Seminarin fillestar të projektit dhe vizitat njohëse në IDB/HQ.

Financimi i "ISTISNA'A" i IDB-së do të përdoret për komponentin e punimeve civile të projektit.

VENDIM Nr.62, datë 23.9.2010

PËR DHËNIE PËLQIMI PËR EMËRIMIN E ZOTIT BASHKIM DEDJA KRYETAR I GJYKATËS KUSHTETUESE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 pika 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 pika 6 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6685, datë 21.9.2010,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Bashkim Dedja, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6679, datë 15.9.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Alban Lulzim Caslli
2. Alketa Musa Tabaku
3. Amarildo Spiro Ndoni
4. Anila Shaban Kokonozi (Haziraj)
5. Anxhela Adrian Xhaferaj
6. Arben Shuaip Elmazi
7. Ardian Nevruz Xhaferaj
8. Arjola Stefan Kristo
9. Daniel Agim Kondi
10. Eduart Teki Temaj
11. Eglantina Petraq Rutter (Jorgo)
12. Gentjana Osman Xhura (Alushi)
13. Julia Tabaku
14. Kevin Alban Caslli
15. Luan Yzedini Rakipi
16. Mire Dash Zeqiri (Gjongeci)
17. Mirela Leonard Temaj (Çipi)
18. Vili Nikolla Dhamo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr.3, datë 16.8.2010

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E PAJISJES SË SHTETASVE TË HUAJ,
REZIDENTË DHE JOREZIDENTË, ME LEJE GJUETIE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr.10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”,

UDHËZOJMË:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Gjuetia nga shtetasit e huaj, rezidentë dhe jorezidentë, zhvillohet sipas dispozitave të ligjit nr.10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë” dhe akteve normative në zbatim të tij.

2. Shtetasit e huaj zhvillojnë veprimtarinë e gjuetisë brenda sezonit të miratuar, në ditët e caktuara për gjueti, në zonat e lejuara, për llojet e faunës së egër objekt gjuetie, si dhe brenda limiteve ditore për çdo gjuetar.

II. GJUETIA NGA SHTETASIT E HUAJ REZIDENTË

1. Shtetasit e huaj rezidentë në Shqipëri pajisen me leje gjuetie duke ndjekur të gjitha procedurat si për gjuetarët vendas.

2. Shtetasit e huaj rezidentë paraqiten pranë drejtorive të shërbimit pyjor (DSHP) përkatëse në mënyrë individuale duke paraqitur dokumentet e mëposhtme:

a) Dokumentin e identitetit;

b) Lejen e qëndrimit, të lëshuar nga Ministria e Brendshme;

c) Autorizimin e mbajtjes dhe përdorimit të armës së gjahut, të lëshuar nga Policia e Shtetit.

III. GJUETIA NGA SHTETASIT E HUAJ JOREZIDENTË

1. Gjuetia nga shtetasit jorezidentë kryhet në mënyrë të organizuar nga subjekte, të cilat kanë zona gjuetie në përdorim dhe që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre organizimin e gjuetisë turistike.

2. Të drejtën për të organizuar gjueti turistike e kanë edhe personat fizikë apo juridikë, dhe shoqatat e gjuetarëve që kanë sipërfaqe në përdorim për mbarështimin e faunës së egër dhe ushtrimin e gjuetisë, dhe zona të lejuara për gjueti.

3. Drejtoritë e shërbimit pyjor, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, para çdo sezoni, dërgojnë pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave listën e subjekteve dhe personave fizikë, juridikë apo shoqatave që kanë fituar të drejtën e përdorimit të zonave të gjuetisë apo të mbarështimit të faunës së egër objekt gjuetie.

4. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, para fillimit të çdo sezoni gjuetie, dërgon pranë Ministrisë së Brendshme listën e subjekteve fituese që kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë e gjuetisë turistike (qarku, rrethi) për të kryer veprime të mëtejshme për pajisjen e shtetasve të huaj me autorizim për mbajtje arme gjahu dhe municioneve përkatëse për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Gjatë sezonit të gjuetisë subjektet, personat fizikë e juridikë apo shoqatat që kanë fituar të drejtën e përdorimit të zonave të gjuetisë apo të mbarështimit të faunës së egër objekt gjuetie, për çdo hyrje të shtetasve të huaj me armë gjahu për gjueti turistike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, me shkresë zyrtare dhe shtatë ditë para mbërritjes në pikën e kalimit kufitar (PKK) të këtyre shtetasve, i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit pajisjen me autorizim të përkohshëm, për mbajtje dhe përdorim arme gjahu, për një periudhë të caktuar kohe, me këto të dhëna:

a) Emër dhe mbiemër;

b) Numrin e dokumentit të identifikimit;

c) Numrin, markën dhe kalibrin e armës;

d) Sasinë e fishekëve, të cilët nuk mund të jenë më shumë se 50 copë;

e) Datën, PKK, ku do të hyjë shtetasi i huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, datën, PKK të daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Rendit dhe Sigurisë Publike), pas shqyrtimit të kërkesës, lëshon autorizimet përkatëse dhe ia dërgon subjektit kërkues dhe një kopje për dijeni Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

7. Subjektet fizike, juridike apo shoqatat që kanë zona në përdorim dhe mbarështojnë faunën e egër, dorëzojnë në komisariatit e policisë të rrethit dhe DSHP-në përkatëse një kopje të autorizimit të përkohshëm për mbajtje dhe përdorim arme gjahu.

8. Në përfundim të ditës së gjuetisë dhe të sezonit të gjuetisë, subjektet dërgojnë informacionin pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor mbi llojet dhe numrin e krerëve të gjuajtur.

IV. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë e shërbimit pyjor, Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin dhe Drejtoria e Biodiversitetit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Drejtoria e Rendit dhe Sigurisë Publike) të Ministrisë së Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

UDHËZIM
Nr.17, datë 2.9.2010

MBI RREGULLAT E ZBATUESHME TË OPERIMIT NË FUSHËN E SHËRBIMEVE
AJRORE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në përputhje me ligjin nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, neni 11/5, neni 13/5 dhe neni 17/4,

UDHËZOJ:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe kritereve për licencimin e transportuesve ajrorë civile të Republikës së Shqipërisë, për të kryer shërbime ajrore dhe përcakton rregullat e vendosjes së çmimeve të shërbimeve ajrore.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi:

1. “Licencë operimi” do të thotë një autorizim i dhënë nga autoriteti kompetent licencues, një sipërmarrjeje, për të kryer transport ajror të pasagjerëve, të postës dhe/ose të ngarkesave, duke e lejuar atë të ofrojë shërbime ajrore, siç është përcaktuar në Certifikatën e Operimit Ajror (AOC).

2. “Autoriteti kompetent licencues” do të thotë Autoriteti i Aviacionit Civil që ka të drejtë të japë, të refuzojë, të anulojë ose të pezullojë një licencë operimi, në përputhje me kapitullin II.

3. “Komision” do të thotë Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit, i cili është një strukturë e posaçme administrative që krijohet nga titullari i autoritetit licencues kompetent.

4. “Sipërmarrje” do të thotë çdo person fizik ose juridik, qoftë fitimprurës ose jo, ose çdo organ tjetër zyrtar, qoftë me personalitetin e vet juridik ose jo.

5. “Shërbim ajror” do të thotë një fluturim ose një seri fluturimesh me qëllim transportin e pasagjerëve, ngarkesës dhe/ose postës me pagesë dhe/ose me qira.

6. “Fluturim” do të thotë një nisje nga një aeroport i caktuar drejt një aeroporti të një destinacioni të caktuar.

7. “Fluturime lokale (të brendshme)” do të thotë një fluturim që nuk përfshin transportin e pasagjerëve, postës dhe/ose ngarkesës ndërmjet aeroporteve të ndryshme ose pika të tjera të autorizuara uljeje.

8. “Aeroport” do të thotë çdo zonë e përshtatur veçanërisht për shërbime ajrore.

9. “Certifikata e Operimit Ajror (AOC)” do të thotë një certifikatë e dhënë një sipërmarrjeje që provon se operatori ka aftësinë dhe organizimin profesional për të garantuar sigurinë e operimeve të përcaktuara në certifikatë, siç parashikohet në dispozitat përkatëse ligjore e nënligjore.

10. “Kontroll efektiv” do të thotë një marrëdhënie e përbërë nga të drejta, kontrata ose çdo mjet tjetër, i cili qoftë individualisht, ose bashkërisht dhe duke marrë parasysh konsideratat e faktit ose ligjit të përfshirë, jep mundësinë e ushtrimit direkt ose indirekt të një ndikimi vendimtar mbi një sipërmarrje, veçanërisht në:

a) të drejtën për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të një sipërmarrjeje;

b) të drejta ose kontrata që japin një ndikim vendimtar në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve të një sipërmarrjeje ose ndryshe japin një ndikim vendimtar në funksionimin e biznesit të një sipërmarrjeje.

11. “Transportues ajror” do të thotë një sipërmarrje me një licencë të vlefshme operimi ose një licence operimi ekuivalente.

12. “Transportues ajror i huaj” do të thotë një transportues ajror me një licencë të vlefshme operimi të dhënë nga një autoritet licencues kompetent i huaj.

13. “Plan biznesi” do të thotë një përshkrim i hollësishëm i veprimtarive tregtare të synuara nga transportuesi ajror për periudhën në fjalë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e pritshëm të tregut dhe investimet që do të kryhen, duke përfshirë implikimet financiare dhe ekonomike të këtyre veprimtarive.

14. “E drejta e trafikut” do të thotë e drejta për të kryer një shërbim ajror ndërmjet dy aeroporteve me qëllim transportimin e pasagjerëve, mallrave dhe postës, për qëllime fitimi.

15. “Shitje vetëm e vendit” do të thotë shitje e vendeve pa ndonjë shërbim tjetër shtesë (si p.sh. akomodimi), direkt te publiku nga transportuesi ajror ose agjenti i tij i autorizuar ose një marrës me qira (charter).

16. “Shërbim ajror i programuar” do të thotë një seri fluturimesh që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

a) në çdo fluturim vendet dhe/ose kapaciteti për të transportuar ngarkesë dhe/ose postë janë të disponueshme për blerje individuale nga publiku (ose direkt nga transportuesi ajror, ose nga agjentët e tij të autorizuar);

b) operohet në mënyrë që të kryhet lëvizja ndërmjet dy ose më shumë aeroporteve, ose:

- sipas orarit të publikuar, ose

- me fluturime aq të rregullta dhe të shpeshta sa të përbëjnë një seri sistematike që mund të njihet.

17. “Kapacitet” do të thotë numri i vendeve ose ngarkesa me fitim e ofruar publikut të gjerë në një shërbim ajror të programuar për një periudhë të caktuar.

18. “Çmime ajrore” do të thotë çmimet e shprehura në lekë ose në euro që u paguhen transportuesve ajrorë ose agjentëve të tyre, ose shitësve të tjerë të biletave për transportimin e pasagjerëve në shërbime ajrore dhe çdo kusht me të cilin aplikohen këto çmime, duke përfshirë pagesa dhe kushte të ofruara agjencisë dhe shërbime të tjera ndihmëse.

19. “Tarifat ajrore” do të thotë çmimet e shprehura në lekë ose në euro që paguhen për transportimin e ngarkesave dhe kushtet me të cilat aplikohen këto çmime, duke përfshirë pagesa dhe kushte të ofruara agjencisë dhe shërbime të tjera ndihmëse.

20. “Bashkim urban” do të thotë një zonë urbane që përfshin një numër qytetesh ose qytezash, të cilat me rritjen dhe zgjerimin e popullsisë, janë shkrirë në mënyrë të natyrshme për të formuar gradualisht një zonë të vazhdueshme.

21. “Llogaria e menaxhimit” do të thotë një deklaratë e hollësishme e të ardhurave dhe shpenzimeve të transportuesit ajror për periudhën në fjalë, duke përfshirë një dobësim ndërmjet aktiviteteve të lidhura me transportin dhe aktiviteteve të tjera, si dhe ndërmjet elementeve në para dhe jo në para.

22. “Marrëveshje e qirasë së avionëve pa personelin dhe sigurimin (Dry Lease)” do të thotë një marrëveshje ndërmjet sipërmarrjeve, sipas së cilës avioni operohet nën AOC- në e qiramarrësit.

23. “Marrëveshje e qirasë së avionëve së bashku me personelin dhe sigurimin (Wet lease)” do të thotë një marrëveshje ndërmjet transportuesve ajrorë, sipas së cilës avioni operohet nën AOC- në e qiradhënësit.

24. “Vendi kryesor i biznesit” do të thotë zyra qendrore ose zyra e regjistruar e një transportuesi ajror në Republikën e Shqipërisë, brenda të cilit ushtrohen funksionet kryesore financiare dhe kontrolli operues, duke përfshirë menaxhim të vazhdueshëm të gatishmërisë për punë të avionëve, të transportuesit ajror shqiptar.

KAPITULLI II LICENCA E OPERIMIT

Neni 3

Licenca e operimit

1. Çdo sipërmarrje që plotëson kërkesat e këtij kapitulli do të ketë të drejtë të marrë një licencë operimi.

2. Asnjë sipërmarrje e themeluar në Republikën e Shqipërisë nuk do të lejohet të transportojë në mënyrë ajrore pasagjerë, postë dhe/ose ngarkesë për pagesë dhe/ose qira, nëse nuk i është dhënë një licencë operimi e rregullt.

3. Autoriteti licencues kompetent nuk do të japë licenca operimi ose t'i ruajë ato në fuqi, nëse ka ndonjë mospërputhje me kërkesat e këtij kapitulli.

Neni 4

Dhënia e licencës së operimit

1. Me urdhër të titullarit të autoritetit licencues kompetent, krijohet struktura e posaçme e quajtur Komisioni i Dhënies së Licencave të Operimit.

2. Komisioni ka autoritetin për shqyrtimin, miratimin, refuzimin, anulimin ose pezullimin e një licence operimi.

3. Në urdhrin e krijimit të komisionit përcaktohet përbërja (kryetar, nënkryetar, sekretar dhe anëtarë), kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë sipas kësaj përbërje, dhe mënyra e informimit/raportimit të titullari i autoritetit licencues kompetent. Detyrën e sekretarisë së komisionit e kryen sektori përgjegjës për licencimet në Autoritetin e Aviacionit Civil.

4. Komisioni kryen funksionet në përputhje me këtë udhëzim dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 5

Kushtet për dhënien e një licence operimi

Një sipërmarrjeje i jepet një licencë operimi nga autoriteti licencues kompetent nëse:

a) vendi kryesor i veprimtarisë është Republika e Shqipërisë ose, nëse vendi kryesor i veprimtarisë nuk është Republika e Shqipërisë, zyra ku është regjistruar biznesi të jetë në Republikën e Shqipërisë;

b) zotëron një certifikatë të vlefshme të operatorit ajror, të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, i cili është përgjegjës për dhënien, refuzimin, anulimin ose pezullimin e licencës së operimit të transportuesit ajror;

c) ka një ose më shumë avionë në dispozicion përmes pronësisë ose marrëveshjes së qirasë së avionit pa personelin dhe sigurimin (qira e thatë-*dry lease*);

d) objekti kryesor i veprimtarisë është vetëm transporti ajror ose transporti ajror i kombinuar me çdo operim tjetër tregtar të avionëve apo transporti ajror i kombinuar me riparim dhe mirëmbajtje avionësh;

e) struktura e organizative e saj, mundëson autoritetin licencues kompetent të zbatojë dispozitat e këtij udhëzimi;

f) zotërohet dhe vazhdon të zotërohet drejtpërdrejt ose nëpërmjet shumicës së pronësisë nga Republika e Shqipërisë dhe/ose shtetas të saj, apo një ose a më shumë shtete të ZPEA-së dhe/ose shtetas të ZPEA-së, si dhe është gjatë të gjithë kohës e kontrolluar efektivisht nga Republika e Shqipërisë dhe/ose nga shtetas shqiptarë, ose një a më shumë shtete të ZPEA-së dhe/ose shtetas të tyre, sipas përcaktimeve të marrëveshjes shumëpalëshe;

g) plotëson kushtet financiare të specifikuara në nenin 6 të këtij udhëzimi;

h) përputhet me kërkesat për sigurimin, të përcaktuara në ligjin nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”;

i) përputhet me dispozitat për reputacion të mirë siç specifikohet në nenin 8.

Neni 6

Kushtet financiare për dhënien e një licence operimi

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të vlerësojë nga afër nëse një sipërmarrje që aplikon për herë të parë për një licencë operimi mund të tregojë që:

a) ajo mund të përmbushë në çdo kohë detyrimet e saj aktuale dhe potenciale të ngritura sipas supozimeve reale, për një periudhë prej 24 muajsh nga fillimi i operimeve; dhe

b) ajo mund të ketë aftësi paguese për shpenzimet e saj fikse dhe operative që lindin nga operimet sipas planit të saj të biznesit dhe të ngritura sipas supozimeve reale, për një periudhë prej tre muajsh nga fillimi i operacioneve, pa marrë parasysh ndonjë të ardhur nga operimet.

2. Për qëllimin e vlerësimit të përmendur në paragrafin 1, çdo aplikant do të paraqesë një plan biznesi për të paktën tre vitet e operimit. Plani i biznesit gjithashtu do të përcaktojë hollësisht lidhjet financiare të aplikuesit me çdo veprimtari tjetër tregtare në të cilën aplikanti është i angazhuar ose direkt ose nëpërmjet sipërmarrjeve të lidhura me të. Aplikanti gjithashtu duhet të sigurojë të gjithë informacionin përkatës, veçanërisht të dhënat e përmendura në pikën 1 të aneksit I të këtij udhëzimi.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk do të zbatohen në një sipërmarrje që aplikon për një licencë operimi, me qëllim mbulimin e operimeve me avion me më pak se 10 ton masë uljeje maksimumi (MTOM) dhe/ose më pak se 20 vende. Sipërmarrje të tilla do të tregojnë se kapitali i tyre neto është të paktën 100 000 euro ose të sigurojnë, kur kërkohet nga autoriteti licencues kompetent, të gjithë informacionin përkatës për qëllimin e vlerësimit të përmendur në paragrafin 1, veçanërisht të dhënat e përmendura në pikën 1 të aneksit I.

Megjithatë, autoriteti licencues kompetent mund të zbatojë paragrafët 1 dhe 2 në një sipërmarrje që aplikon për një licencë operimi nën dispozitat e nënparagrafit të mëparshëm, që ka si qëllim të kryejë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja e së cilës i kalon 3 milionë euro në vit.

Neni 7

Certifikata e operatorit ajror

1. Dhënia dhe vlefshmëria e një licence operimi do të jetë në çdo kohë e varur nga zotërimi i një AOC-je, që specifikon aktivitetet e mbuluara nga licenca e operimit.

2. Çdo modifikim në AOC-në e një transportuesi ajror të Republikës së Shqipërisë, do të pasqyrohet, kur duhet, në licencën e tij të operimit.

Neni 8

Prova e reputacionit të mirë

1. Personat që do të menaxhojnë vazhdimisht dhe me efikasitet operacionet e sipërmarrjes duhet të provojnë para autoritetit licencues kompetent se kanë reputacion të mirë ose se ata nuk kanë deklaruar falimentim, në mënyrë që të pajisen me një licencë operimi.

2. Autoriteti licencues kompetent do të pranojë dokumentacionin që provon reputacionin e mirë ose mosshpalljen e falimentimit, nëse është lëshuar jo më shumë se tre muaj që nga data e paraqitjes.

Neni 9

Vlefshmëria e licencës së operimit

1. Një licencë operimi do të jetë e vlefshme për sa kohë që transportuesi ajror i Republikës së Shqipërisë përmbush kërkesat e këtij kapitulli.

Një transportues ajror i RSH-së duhet të jetë i aftë t'i demonstrojë në çdo kohë me kërkesë të autoritetit licencues kompetent se ai plotëson të gjitha kërkesat e këtij kapitulli.

2. Autoriteti licencues kompetent do të monitorojë nga afër përputhshmërinë me kërkesat e këtij kapitulli. Megjithatë, autoritetit licencues kompetent do të rishikojë përputhshmërinë me këto kërkesa në rastet e mëposhtme:

- a) dy vjet pasi është dhënë një licencë e re operimi;
- b) kur dyshohet një problem i mundshëm; ose
- c) me kërkesë të çdo institucioni tjetër.

Në rast se autoriteti licencues kompetent dyshon se problemet financiare të një transportuesi ajror të huaj mund të cenojnë sigurinë e operimeve të tij, autoriteti do të informojë menjëherë autoritetin kompetent të huaj që ka lëshuar AOC.

3. Licenca e operimit do të paraqitet përsëri për miratim kur një transportues ajror i Republikës së Shqipërisë:

- a) nuk ka filluar operimet brenda gjashtë muajve nga dhënia e licencës së operimit;
- b) ka ndërprerë operimet e tij për më shumë se gjashtë muaj; ose
- c) kur është licencuar në bazë të nënparagrafit të parë të nenit 6(3) dhe synon të angazhohet në operime me avion mbi kufirin minimal të specifikuar në nenin 6(3), ose nuk plotëson më kushtet financiare të vendosura në të.

4. Një transportues ajror i RSH-së do t'i vërë në dispozicion autoritetit licencues kompetent, llogaritë e tij të audituara, jo më vonë se gjashtë muaj pas ditës së fundit të vitit financiar përkatës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në një akt tjetër ligjor. Gjatë dy viteve të para të operimeve të një transportuesi ajror të RSH-së, të dhënat që përmenden në pikën 3 të aneksit I të këtij udhëzimi, do t'i vihen në dispozicion autoritetit licencues kompetent, me kërkesën e tij.

Autoriteti licencues kompetent mund të vlerësojë në çdo kohë performancën financiare të një transportuesi ajror të RSH-së, të cilit ai i ka dhënë një licencë operimi, duke kërkuar informacionin përkatës. Si pjesë e një vlerësimi të tillë, transportuesi ajror i RSH-së, në fjalë, do të përditësojë të dhënat e përmendura në pikën 3 të aneksit I dhe do t'ia vërë në dispozicion autoritetit licencues kompetent, sipas kërkesës së tij.

5. Një transportues ajror i RSH-së do të njoftojë autoritetin licencues kompetent:

- a) paraprakisht për çdo planifikim në lidhje me kryerjen e një shërbimi të ri ajror në një kontinent ose rajon të botës që nuk është paraqitur më parë, ose për çdo ndryshim tjetër thelbësor në gamën e aktiviteteve të tij, duke përfshirë, por jo kufizuar në, ndryshime në tipin ose numrin e avionëve të përdorur;
- b) paraprakisht për çdo shkrirje ose blerje të synuar; dhe
- c) brenda 14 ditëve për çdo ndryshim në pronësi të çdo aksioni që përfaqëson 10% ose më shumë të aksioneve të përgjithshme të transportuesit ajror.

6. Nëse autoriteti licencues kompetent çmon se ndryshimet e shpallura në pikën 5 kanë një lidhje të rëndësishme me financat e transportuesit ajror të RSH-së, ai do të kërkojë paraqitjen e një plani biznesi të rishikuar që përmban ndryshimet në fjalë dhe mbulon të paktën një periudhë prej 12 muajsh nga data e implementimit të tij, si dhe të dhënat e përmendura në pikën 2 të aneksit I, si dhe informacionin që duhet të sigurohet sipas paragrafit 4.

Autoriteti licencues kompetent do të marrë një vendim për planin e rishikuar të biznesit, nëse transportuesi ajror i RSH-së mund të plotësojë detyrimet potenciale dhe ekzistuese gjatë asaj periudhe prej 12 muajsh. Një vendim i tillë do të merret jo më vonë se tre muaj pasi t'i jetë

paraqitur i gjithë informacioni i nevojshëm.

7. Autoriteti licencues kompetent, në lidhje me transportuesit ajrorë të RSH-së të licencuar nga vetë ai, do të vendosë nëse licenca e operimit duhet të paraqitet përsëri për miratim në rast ndryshimi në një ose më shumë elementeve që cenojnë statusin ligjor të tij dhe në veçanti në rastin e një shkrirjeje ose blerje të aksioneve.

8. Paragrafët 4, 5 dhe 6 nuk do të zbatohen për transportuesit ajrorë të RSH-së të angazhuar me avionë më pak se 10 ton MTOM dhe/ose më pak se 20 vende. Transportues të tillë ajrorë duhet të jenë të aftë të demonstrojnë në çdo kohë se kapitali i tyre neto është të paktën 100 000 euro ose të sigurojnë, kur kërkohet nga autoriteti licencues kompetent, informacionin përkatës për qëllimet e vlerësimit të përmendur në nenin 10(2).

Megjithatë, autoriteti licencues kompetent mund të zbatojë paragrafët 4, 5 dhe 6 për transportuesit ajrorë të RSH-së të licencuar nga ai, që kryejnë shërbime ajrore të programuara ose xhiroja financiare e të cilëve kalon 3 milionë euro në vit.

Neni 10

Pezullimi dhe anulimi i një licence operimi

1. Autoriteti licencues kompetent mund të vlerësojë në çdo kohë performancën financiare të një transportuesi ajror të RSH-së që ai ka licencuar. Në bazë të këtij vlerësimi, autoriteti merr vendim për pezullimin ose anulimin e licencës së operimit, nëse ai nuk është më i bindur që ky transportues ajror mund të përmbushë detyrimet e tij potenciale dhe aktuale për një periudhë prej 12 muajsh.

Megjithatë, autoriteti licencues kompetent mund të japë një licencë të përkohshme, që nuk i kalon 12 muaj, në pritje të riorganizimit financiar të një transportuesi ajror të RSH-së me kusht që siguria të mos jetë në rrezik dhe të ekzistojë një perspektivë reale për një përmirësim të kënaqshëm financiar brenda kësaj periudhe kohore. Kjo licencë e përkohshme pasqyron, kur duhet, çdo ndryshim në AOC.

2. Kur ka tregues të qartë se ekzistojnë probleme financiare ose janë hapur procese procedurale të lidhura me paaftësinë paguese ose procese të ngjashme kundrejt një transportuesi ajror të RSH-së të licencuar, autoriteti licencues kompetent do të kryejë pa vonesë një vlerësim të hollësishëm të situatës financiare dhe në bazë të rezultateve të tij, do të rishikojë statusin e licencës së operimit në përputhje me këtë nen brenda një periudhe kohe prej tre muajsh.

3. Kur llogaritë e audituara, të përmendura në nenin 9(4), nuk janë paraqitur brenda afatit të parashikuar, autoriteti licencues kompetent ka të drejtë t'i kërkojë transportuesit ajror të RSH-së, paraqitjen e llogarive të audituara pa vonesa të tepruara.

Nëse llogaritë e audituara, nuk paraqiten brenda një muaji, licenca e operimit mund të anulohet ose pezullohet.

4. Autoriteti licencues kompetent do të pezullojë ose anulojë licencën e operimit, nëse transportuesi ajror i RSH-së, me dashje ose nga pakujdesia, i jep autoritetit informacion të rremë për një çështje të rëndësishme.

5. Në rast se AOC-ja e një transportuesi ajror të RSH-së pezullohet ose anulohet, autoriteti do të pezullojë ose anulojë menjëherë licencën e operimit të transportuesit ajror.

6. Autoriteti mund të pezullojë ose anulojë licencën e operimit të një transportuesi ajror të RSH-së, nëse transportuesi ajror nuk plotëson më kërkesat në lidhje me reputacionin e mirë të përcaktuar në nenin 8.

Neni 11

Vendime për licencën e operimit

1. Autoriteti licencues kompetent do të marrë një vendim për një aplikim sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se tre muaj pasi të jetë paraqitur i gjithë informacioni i nevojshëm, duke marrë parasysh të gjitha provat e disponueshme. Vendimi do t'i njoftohet aplikantit. Në rastin e refuzimit, paraqiten arsyet përkatëse në lidhje me të.

2. Procedura të detajuara për dhënien, pezullimin dhe anulimin e licencave të operimit do të publikohen nga autoriteti licencues kompetent dhe njëkohësisht do të informojë Ministrin, sipas përcaktimeve të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë.

3. Vendimet lidhur me dhënien, pezullimin apo anulimin e licencave të operimit do të publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Neni 12 Kërkesat e sigurimit

Pavarësisht nga parashikimet e ligjit nr.10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, një transportues ajror i RSH-së do të sigurohet për të mbuluar detyrimin në raste aksidentesh në lidhje me postën.

Neni 13 Regjistrimi

1. Pa cenuar nenin 14(3) të këtij udhëzimi, për regjistrimin e avionit do të zbatohen parashikimet e nenit 21 të Kodit Ajror.

2. Në përputhje me paragrafin 1, Autoriteti i Aviacionit Civil do të regjistrojë avionët në regjistrin e tij kombëtar pas pagesës së tarifës normale të regjistrimit të caktuar për këtë qëllim.

Neni 14 Qiraja

1. Pa cenuar nenin 5(c), një transportues ajror i RSH-së, mund të ketë një ose më shumë avionë në dispozicion të tij nga marrëveshja e qirasë së avionit me ose pa personelin dhe sigurimin (*dry* ose *wet lease*). Transportuesit ajrorë të RSH-së mund të aplikojnë për marrjen dhe përdorin lirisht avionë me qira së bashku me personelin ose pa të; sigurimin dhe përgjegjësinë e plotë ndaj pasagjerëve (në rastin *wet lease*) të regjistruar brenda BE-së ose jashtë saj, përveçse kur kjo do të vinte në rrezik sigurinë ose do të bënte pjesë në sistemin “*black list*” të BE-së. Autoriteti i Aviacionit Civil do të garantojë se implementimi i një dispozite të tillë është i arsyeshëm dhe proporcional dhe i bazuar në faktorët e sigurisë.

2. Marrëveshja e qirasë së avionit pa personelin dhe sigurimin (*dry lease*) në të cilën një transportues ajror i RSH-së është palë ose një marrëveshje e qirasë së avionit së bashku me personelin dhe sigurimin, në të cilën transportuesi ajror i RSH-së është qiramarrësi i avionit i marrë me qira së bashku me personelin dhe sigurimin, do t’i nënshtrohet një miratimi të mëparshëm nga ana e sigurisë ajrore (autoriteti certifikues) në përputhje me ligjin kombëtar ose të akteve nënligjore të zbatueshme për sigurinë e avionëve.

3. Një avion me qira, së bashku me personelin, sigurimin dhe përgjegjësinë e plotë ndaj pasagjerëve e mallrave i një transportuesi ajror të BE-së, i regjistruar në një vend të tretë nga një sipërmarrje tjetër, do të marrë miratim të mëparshëm për operimin nga autoriteti certifikues kompetent ose autoriteti që ka lëshuar AOC. Autoriteti certifikues kompetent mund të japë një miratim nëse:

a) transportuesi ajror i demonstroi autoritetit kompetent se të gjitha standardet e sigurisë të barasvlefshme me ato të vendosura nga ligji kombëtar përmbushen dhe

b) plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

i) transportuesi ajror justifikon një dhënie me qira të tillë në bazë të nevojave të jashtëzakonshme, që në këtë rast mund të jepet miratim për një periudhë deri në shtatë muaj që mund të rinovohet njëherë për një periudhë të mëtejshme deri në shtatë muaj;

ii) transportuesi ajror demonstroi se dhënia me qira është e nevojshme për të plotësuar nevojat e kapacitetit sezonal, që nuk mund të plotësohet në mënyrë të arsyeshme nga avionë të dhënë me qira të regjistruar brenda RSH-së, rast në të cilin miratimi mund të rinovohet; ose

iii) transportuesi ajror demonstroi se dhënia me qira është e nevojshme për të kapërcyer vështirësitë e operimit dhe nuk është e mundur ose e arsyeshme të jepet me qira ndonjë avion i

regjistruar brenda RSH-së, rast në të cilin miratimi do të jetë me një kohëzgjatje të kufizuar pikërisht sa është e nevojshme për kapërcimin e vështirësive.

4. Autoriteti kompetent mund t'i bashkëngjisë kushte miratimit. Këto kushte do të përbëjnë pjesë të marrëveshjes së qirasë së avionit, së bashku me personelin dhe sigurimin për avionin, pasagjerët e mallrat.

Autoriteti kompetent mund të refuzojë të japë një miratim, nëse nuk ka reciprocitet për sa i përket marrëveshjes së qirasë së avionit së bashku me personelin dhe sigurimin ndërmjet RSH-së dhe vendit të tretë ku është regjistruar avioni i dhënë me qira, së bashku me personelin dhe sigurimin për avionin, pasagjerët e mallrat.

Autoriteti kompetent mund të informojë shtetet e interesuara për një miratim që ai ka dhënë për avion të dhënë me qira, së bashku me personelin dhe sigurimin për avionin, pasagjerët dhe mallrat, të regjistruar në një vend të tretë.

Neni 15

E drejta për t'u dëgjuar

Autoriteti licencues kompetent, përpara se të vendosë pezullimin apo anulimin e licencës së operimit të transportuesit ajror të RSH-së, duhet të garantojë të drejtën e transportuesit për t'u dëgjuar e për të dhënë shpjegime relevante mbi çështjen objekt shqyrtimi.

Ky rregull vlen edhe në rastet e ndjekjes së një procedure urgjente.

KAPITULLI III

AKSESI NË ITINERARE

Neni 16

Ofrimi i shërbimeve ajrore

1. Transportuesit ajrorë të Republikës së Shqipërisë dhe transportuesit ajrorë të huaj kanë të drejtë të kryejë shërbime ajrore në përputhje me nenin 17 të Kodit Ajror.

2. Gjatë operimit të shërbimeve ajrore, si transportuesit ajrorë të RSH-së, ashtu edhe transportuesit ajrorë të huaj, do të lejohen të kombinojnë shërbime ajrore dhe të lidhin marrëveshje për ndarjen e Kodit, pa cenuar rregullat e konkurrencës të aplikueshme për sipërmarrjet në Republikën e Shqipërisë.

Çdo kufizim i lirisë së transportuesve ajrorë shqiptarë dhe të huaj për të kryer shërbime ajrore do të bëhet nga Autoriteti i Aviacionit Civil, në përputhje me rregulloren e miratuar nga Ministri në zbatim të nenit 17/4 të Kodit Ajror.

3. Pavarësisht nga dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe ku shteti shqiptar është palë dhe duke iu nënshtruar rregullave të konkurrencës të zbatueshme për sipërmarrjet, transportuesit ajrorë do të lejohen të kombinojnë shërbime ajrore dhe të lidhin marrëveshje për ndarjen e kodit me çdo transportues ajror për shërbime ajrore për, nga ose nëpërmjet çdo aeroporti shqiptar ose në çdo pikë(a) në vende të treta.

Në kuadrin e marrëveshjes dypalëshe të shërbimit ajror me vendin e tretë në fjalë, një shtet anëtar mund të vendosë kufizime në marrëveshjet e ndarjes së kodit ndërmjet transportuesve ajrorë të Komunitetit dhe transportuesve ajrorë të një vendi të tretë, veçanërisht nëse vendi i tretë në fjalë nuk i lejon mundësi të ngjashme tregtare transportuesve ajrorë të Komunitetit që operojnë nga shteti anëtar në fjalë. Duke bërë kështu, shtetet anëtare do të garantojnë se kufizimet e vendosura sipas këtyre marrëveshjeve, nuk kufizojnë konkurrencën dhe janë jodiskriminuese ndërmjet transportuesve ajrorë të Komunitetit dhe se ato nuk janë më kufizuese sesa është e nevojshme.

Parime të përgjithshme për detyrimet e shërbimit publik

1. Ministri mund të vendosë një detyrim shërbimi publik në lidhje me shërbimet ajrore të programuara ndërmjet një aeroporti të huaj dhe një aeroporti që operon në një rajon periferik ose në zhvillim në territorin shqiptar ose në një itinerar të caktuar për në çdo aeroport shqiptar, duke u konsideruar çdo itinerar i tillë me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit në të cilin operon aeroporti. Ky detyrim do të vendoset vetëm për shtrirjen e nevojshme për të garantuar në atë itinerar sigurimin minimal të shërbimeve ajrore të programuara, që plotësojnë standardet fikse të vazhdimësisë, rregullsisë, çmimit ose kapacitetit minimal, të cilat transportuesit ajrorë nuk do t'i pranonin nëse do të merrnin në konsideratë vetëm interesat e tyre tregtare.

Standardet fikse të vendosura në itinerarin që i nënshtrohet atij detyrimi të shërbimit publik, do të vendosen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

2. Në rastet kur mjete të tjera transporti nuk mund të sigurojnë një shërbim të pandërprerë me të paktën një shpeshësi dyditore, Ministri mund të përfshijë në detyrimin e shërbimit publik kërkesën që çdo transportues ajror që synon të operojë itinerarin, të japë një garanci që ai do të operojë itinerarin për një periudhë të caktuar, që do të përcaktohet në përputhje me kushtet e tjera të detyrimit të shërbimit publik.

3. Nevoja dhe përshatshmëria e një detyrimi të shërbimit publik të parashikuar do të vlerësohet në lidhje me:

a) proporcionalitetin ndërmjet detyrimit të parashikuar dhe nevojave për zhvillim ekonomik të rajonit në fjalë;

b) mundësinë për të pasur mbështetje në mjetet e tjera të transportit dhe aftësinë e këtyre mjeteve për të plotësuar nevojat e transportit nën shqyrtim, veçanërisht kur shërbimet ekzistuese hekurudhore kryen në itinerarin e parashikuar me një kohë udhëtimi prej më pak se tri orësh dhe me shpeshësi, lidhje të mjaftueshme dhe koordinime të përshtatshme;

c) çmimet ajrore dhe kushtet që mund t'u caktohen përdoruesve;

d) efektin e kombinuar të të gjithë transportuesve ajrorë që operojnë ose synojnë të operojnë në itinerar.

4. Në rast të vendosjes së detyrimit të shërbimit publik, Autoriteti i Aviacionit Civil do t'u komunikojë tekstin e vendosjes së parashikuar të detyrimit të shërbimit publik autoriteteve kompetente të huaja të përfshira, aeroportëve në fjalë dhe transportuesve ajrorë që operojnë itinerarin në fjalë.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të publikojë një njoftim informacioni në faqen zyrtare të tij:

a) duke identifikuar dy aeroportet e lidhura nga itinerari në fjalë dhe pikën(at) e mundshme të ndërmjetme të ndalimit;

b) duke përmendur datën e hyrjes në fuqi të detyrimit të shërbimit publik; dhe

c) duke ofruar çdo informacion përkatës dhe/ose dokumentacion në lidhje me detyrimin e shërbimit publik, i cili do të bëhet i disponueshëm pa vonesë dhe falas nga autoriteti.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4 në lidhje me itineraret, kur numri i pasagjerëve që pritet të përdorë shërbimin ajror është më pak se 10 000 në vit, njoftimi i informacionit për një detyrim të shërbimit publik do të publikohet në Fletoren Zyrtare.

6. Data e hyrjes në fuqi e një detyrimi të shërbimit publik nuk do të jetë më e hershme sesa data e publikimit të njoftimit të informacionit të përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 4.

7. Kur një detyrim i shërbimit publik është vendosur në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, transportuesit ajrorë do të jenë të aftë të ofrojnë shitje vetëm të vendeve, me kusht që shërbimi ajror në fjalë të plotësojë të gjitha kërkesat e detyrimit të shërbimit publik. Rrjedhimisht, ai shërbim ajror do të konsiderohet si shërbim ajror i programuar.

8. Kur një detyrim i shërbimit publik është vendosur në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, çdo transportues tjetër ajror do të lejohet në çdo kohë të fillojë shërbime ajrore të programuara që plotësojnë të gjitha kërkesat e detyrimit të shërbimit publik, duke përfshirë periudhën e operimit që mund të kërkohet në përputhje me paragrafin 2.

9. Pavarësisht nga paragrafi 8, nëse asnjë transportues ajror nuk ka filluar ose nuk mund të demonstrojë se është gati për të filluar shërbime ajrore të programuara të vërtetueshme në një itinerar në përputhje me detyrimin e shërbimit publik, i cili është vendosur në atë itinerar, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kufizojë aksesin në shërbimet ajrore të programuara në atë itinerar vetëm në një transportues ajror për një periudhë deri në katër vjet, pas së cilës situata do të rishikohet.

10. E drejta për të kryer shërbimet e përmendura në paragrafin 9 do të ofrohet me tender publik në përputhje me nenin 18, ose veçmas ose, në rastet kur justifikohet për arsyet e efikasitetit operativ, për një grup itinaresh të tillë për çdo transportues ajror që ka të drejtë të kryejë shërbime të tilla publike. Për arsye të efikasitetit administrativ mund të ofrohet një ftesë e vetme për tender, e cila mund të mbulojë itinaresh të ndryshme.

11. Një detyrim i shërbimit publik do të çmohet se ka skaduar, nëse asnjë shërbim ajror i programuar nuk është kryer gjatë një periudhe prej 12 muajsh në itinerarin që i nënshtrohet një detyrimi të tillë.

12. Në rast të një ndërprerjeje të papritur të shërbimit nga transportuesi ajror i zgjedhur në përputhje me nenin 17, në rast emergjence, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të zgjedhë një tjetër transportues ajror për të kryer detyrimin e shërbimit publik për një periudhë deri në shtatë muaj, të parinovueshme, me kushtet e mëposhtme:

a) çdo kompensim i paguar duhet të bëhet në përputhje me nenin 18 (8);

b) zgjedhja do të bëhet ndërmjet transportuesve ajrorë shqiptarë e të huaj, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit;

c) do të paraqesë një kërkesë të re për tender.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të publikojë pa vonesë në faqen zyrtare të tij një informacion për procedurën e emergjencës dhe për arsyet e saj.

Neni 18

Procedura e tenderit publik për detyrimin e shërbimit publik

1. Tenderi publik i kërkuar në nenin 17(10) do të kryhet sipas procedurës së vendosur në paragrafët 2 deri 10 të këtij neni.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil respekton legjislationin e prokurimeve publike në fuqi në rastin e ftesës për tender lidhur me detyrimin e shërbimit publik.

3. Ftesa për tender dhe kontrata pasuese do të mbulojnë ndër të tjera pikat e mëposhtme:

a) standardet e kërkuara nga detyrimi i shërbimit publik;

b) rregullat në lidhje me amendimin dhe përfundimin e kontratës; veçanërisht për të marrë parasysh ndryshimet e paparashikueshme;

c) periudhën e vlefshmërisë së kontratës;

d) sanksionet në rastin e dështimit për të përmbushur kontratën;

e) parametrat objektivë dhe transparentë në bazë të të cilave do të llogaritet kompensimi, nëse ka, për shlyerjen e detyrimit të shërbimit publik.

4. Në rast se tenderat i përkasin një itinerari për të cilin aksesin është kufizuar tashmë në një transportues në përputhje me nenin 17(9), ftesa për tender do të publikohet të paktën gjashtë muaj para fillimit të koncesionit të ri për të vlerësuar nevojën e vazhdueshme të aksesit të kufizuar.

5. Autoriteti i Aviacionit Civil do të sigurojë pa vonesë dhe falas çdo informacion përkatës dhe dokumente të kërkuara nga një palë e interesuar për tenderin publik.

6. Përzgjedhja do të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur duke marrë në konsideratë përshtatshmërinë e shërbimit, duke përfshirë çmimet dhe kushtet që mund t'u caktohen përdoruesve dhe koston e kompensimit të kërkuar nga shteti(et) anëtar(e) në fjalë, nëse ka.

7. Transportuesi ajror i përzgjedhur, sipas paragrafit 6 mund të kompensohet për t'iu përmbajtur standardeve të kërkuara nga një detyrim i shërbimit publik i vendosur sipas nenit 17. Një kompensim i tillë nuk mund të kalojë shumën e kërkuar për të mbuluar shpenzimet neto që lindin për shlyerjen e çdo detyrimi të shërbimit publik, duke marrë parasysh të ardhurat në lidhje me to të mbajtura nga transportuesi ajror dhe një përfitim të arsyeshëm.

8. Autoriteti i Aviacionit Civil do të publikojë në faqen zyrtare pa vonesë rezultatet e tenderit publik, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

- a) elementet operative në përmbajtje të ofertave;
- b) kompensimi i kërkuar në oferta;
- c) emri i tenderuesit të zgjedhur.

Neni 19

Shqyrtimi i detyrimeve të shërbimit publik

1. Çdo vendim i marrë sipas neneve 17 dhe 18 mund të rishikohet efektivisht dhe, në veçanti, sa më shpejt të jetë e mundur në zbatim të legjislacion mbi prokurimet publike.

Transportuesit ajrorë kanë të drejtë t'i kërkojnë Autoritetit të Aviacionit Civil informacion mbi:

- a) një dokument që justifikon nevojën për detyrim të shërbimit publik dhe në përputhje me kriteret e përmendura në nenin 17;
- b) një analizë të ekonomisë në rajon;
- c) një analizë të proporcionalitetit ndërmjet detyrimeve të parashikuara dhe objektivave të zhvillimit ekonomik;
- d) një analizë të shërbimeve ajrore ekzistuese, nëse ka, dhe mjeteve të tjera të transportit të disponueshme që mund të konsiderohen si zëvendësues për taksat e parashikuara.

Neni 20

Shpërndarja e lëvizjes ndërmjet aeroporteve dhe ushtrimi i të drejtave të lëvizjes

1. Ushtrimi i të drejtave të lëvizjes do t'u nënshtrohet rregullave të parashikuara në Kodin Ajror dhe në aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij e që lidhen me sigurinë, ruajtjen, mbrojtjen e mjedisit dhe caktimin e intervaleve kohore.

2. Në zbatim të rregullave transparente, asnjënjë dhe jodiskriminuese, pas konsultimit me palët e interesuara, si dhe në zbatim të parashikimeve të Kodit Ajror dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij, koordinatori i aeroportit ose rregulluesi i orareve do të vendosë shpërndarjen e lëvizjes ajrore ndërmjet aeroporteve duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) aeroportet që operojnë në të njëjtin qytet ose bashkimi urban;
- b) aeroportet operohen nga një infrastrukturë e mjaftueshme transporti, duke siguruar sa më shumë të jetë e mundur, një lidhje direkte duke bërë të mundur të arrihet në aeroport brenda 90 minutave duke përfshirë, ku është e nevojshme, mbi baza ndërkufitare;
- c) aeroportet janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe me qytetin ose bashkimin urban që ato operojnë me shërbime transporti publik të shpeshtë, të besueshëm dhe efikas; dhe
- d) aeroportet i ofrojnë shërbime të nevojshme transportuesve ajrorë dhe nuk i cenojnë padrejtësisht mundësitë e tyre tregtare.

Çdo vendim për të rregulluar shpërndarjen e trafikut ajror ndërmjet aeroporteve do të respektojë parimet e proporcionalitetit dhe transparencës dhe do të bazohet në kriteret objektive.

Neni 21

Masa mjedisore

1. Kur ekzistojnë probleme serioze mjedisore, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kufizojë ose refuzojë ushtrimin e të drejtave të trafikut, veçanërisht kur mjete të tjera transporti sigurojnë nivele të përshtatshme shërbimi. Masa do të jetë jodiskriminuese, nuk do të shtrembërojë konkurrencën ndërmjet transportuesve ajrorë, nuk do të jetë më shumë kufizuese sesa është e nevojshme për të lehtësuar problemet dhe do të ketë një periudhë të caktuar vlefshmërie, që nuk i kalon tre vjetët, pas së cilës do të rishikohet.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil do të publikojë në faqen zyrtare vendimin për kufizimin apo refuzimin e ushtrimit të të drejtave të trafikut, të marrë sipas paragrafit 1.

Neni 22
Masa emergjence

1. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të refuzojë, kufizojë ose vendosë kushte për ushtrimin e të drejtave të trafikut që trajtojnë probleme të papritura me kohëzgjatje të shkurtër që rrjedhin nga rrethana të paparashikueshme dhe të pashmangshme. Akte të tilla do të respektojnë parimet e proporcionalitetit dhe transparencës dhe do të bazohen në kritere objektive dhe jodiskriminuese.

KAPITULLI IV
DISPOZITA PËR VENDOSJEN E ÇMIMEVE

Neni 23
Liria e vendosjes së çmimeve

1. Pa cenuar nenin 17(1) të këtij udhëzimi, si dhe në zbatim të parashikimeve të Kodit Ajror dhe akteve nënligjore për këtë qëllim, çmimet e transportit ajror vendosen lirisht nga tregu.

2. Pavarësisht nga dispozitat e marrëveshjeve bilaterale ku shteti shqiptar është palë, asnjë transportues ajror nuk mund të diskriminohet për shkak të shtetësisë ose identitetit.

Neni 24
Informacioni dhe mosdiskriminimi

1. Çmimet dhe tarifat për shërbime ajrore të disponueshme për publikun e gjerë do të përfshijnë kushtet e zbatueshme kur ofrohen ose publikohen në çdo formë, duke përfshirë ato në internet. Çmimi përfundimtar që duhet të paguhet do të tregohet gjithmonë dhe do të përfshijë çmimin ajror ose tarifën ajrore të zbatueshme, si dhe të gjitha taksat dhe tatimet, shtesat e çmimit dhe tarifat e zbatueshme, të cilat janë të pashmangshme dhe të parashikueshme në momentin e publikimit. Përveç tregimit të çmimit përfundimtar, do të specifikohen të paktën sa më poshtë:

a) çmimi ajror ose tarifa ajrore;

b) taksat;

c) tatimet e aeroportit; dhe

d) tatime, shtesa çmimi ose tarifa, si ato të lidhura me sigurinë ose lëndën djegëse;

ku zërat e përmendur në pikat “b”, “c” dhe “d” i janë shtuar çmimeve ajrore dhe tarifave ajrore. Shtesa çmimi fakultative do të njoftohen në mënyrë të qartë dhe transparente në fillim të procesit të rezervimit dhe pranimi i tyre nga klienti do të jetë mbi një bazë shprehjeje miratimi “pro”.

2. Pa cenuar nenin 17(1), aksesit në çmime dhe tarifa ajrore për shërbimet ajrore, i disponueshëm për publikun e gjerë, do të jepet pa asnjë dallim në bazë të shtetësisë ose vendit të banimit të klientit ose të vendit të themelimit të agjentit të transportuesit ajror ose të shitësit tjetër të biletave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 25
Sanksione

Sanksionet që do të aplikohen, në rast të shkeljes së rregullave të parashikuara në këtë udhëzim, kanë karakter efektiv, proporcional dhe rregullues. Ato bazohen në nenin 142 të Kodit Ajror.

KAPITULLI V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 26
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet çdo akt nënligjor i mëparshëm që rregullon çështjet që përbëjnë objekt të këtij udhëzimi.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

ANEKSI I
INFORMACIONI QË DUHET TË JEPET SIPAS NENEVE 6 DHE 9

1. Informacioni që duhet të jepet nga një aplikues për herë të parë nga pikëpamja e përshtatshmërisë financiare

1.1. Llogaritë e brendshme më të fundit të menaxhimit dhe, nëse disponohen, llogaritë e audituara për vitin e mëparshëm financiar.

1.2. Një bilanc të planifikuar, përfshirë llogaritë e fitimit dhe humbjes për tri vitet e mëpasshme.

1.3. Bazën për shpenzimet e planifikuara dhe shifrat e të ardhurave për zëra të tillë, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifatat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundrimit ajror, shpenzimet bazë të tregtimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.

1.4. Detaje të shpenzimeve të ndezjes/nisjes që kanë ndodhur në periudhën nga paraqitja e një aplikimi për fillimin e operimeve dhe një shpjegim se si propozohet të financohen këto shpenzime.

1.5. Detaje të burimeve financiare ekzistuese dhe të planifikuara.

1.6. Detaje të aksionarëve, duke përfshirë shtetësinë dhe tipin e aksioneve që zotërohen dhe nenet e shoqërisë. Nëse është pjesë e një grupi sipërmarrjesh, informacion për marrëdhëniet ndërmjet tyre.

1.7. Deklarata të planifikuara të qarkullimit të parave dhe planet e likuiditetit për tri vitet e para të operimit.

1.8. Detaje të financimit të blerjes/qiramarrjes së avionëve, duke përfshirë në rastin e qiramarrjes, afatet dhe kushtet e kontratës.

2. Informacioni që duhet të jepet për vlerësimin e përshtatshmërisë financiare të vazhdueshme të mbajtësve të licencës ekzistuese që planifikojnë një ndryshim në strukturën ose aktivitetin e tyre me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre.

2.1. Nëse nevojitet, bilanci i brendshëm më i fundit i menaxhimit dhe llogaritë me audit për vitin e kaluar financiar.

2.2. Detaje të sakta të të gjitha ndryshimeve të propozuara p.sh. ndryshime të tipit të shërbimit, blerja e sipërmarrjes ose shkrirja e propozuar, modifikime në kapitalin aksionar, ndryshime në aksionarë etj.

2.3. Një bilanc i planifikuar, me një llogari fitimi dhe humbjeje për vitin aktual financiar, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e propozuara në strukturë ose aktivitete me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre.

2.4. Shpenzime të kaluara dhe të planifikuara dhe shifra të ardhurash për zëra të tillë, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifatat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundrimit ajror, shpenzimet bazë të tregimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.

2.5. Deklarata të planifikuara të qarkullimit të parave dhe planet e likuiditetit për vitin e ardhshëm, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e propozuara në strukturë ose aktivitete me një lidhje të rëndësishme me financat e tyre.

2.6. Detaje të financimit të blerjes/qiramarrjes së avionëve, duke përfshirë në rastin e qiramarrjes, afatet dhe kushtet e kontratës.

3. Informacioni që duhet dhënë për vlerësimin e përshtatshmërisë financiare të vazhdueshme të mbajtësve ekzistues të licencës.

3.1. Llogaritë e audituara jo më vonë se gjashtë muaj nga dita e fundit e vitit financiar përkatës, vetëm nëse parashikohet ndryshe në ligjin kombëtar, nëse është e nevojshme, bilanci i brendshëm më i fundit i menaxhimit.

3.2. Një bilanc i planifikuar, duke përfshirë llogaritë e fitimit dhe humbjes për vitin e ardhshëm.

3.3. Shpenzime të kaluara dhe të planifikuara dhe shifra të ardhurash për zëra të tillë, si lënda djegëse, çmimet dhe tarifatat, pagat, mirëmbajtja, zhvlerësimi, luhatjet e kursit të këmbimit, tatimet e aeroportit, tatimet e lundrimit ajror, shpenzimet bazë të tregimit, sigurimi etj. Parashikimi i të ardhurave/trafikut.

3.4. Deklarata të qarkullimit të likuiditetit dhe planet e likuiditetit për vitin pasues.

UDHËZIM
Nr.32, datë 21.9.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.24, DATË 2.9.2008 “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 22.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, bëhet shtesa e mëposhtme:

Pika 104.1, germa “c” ndryshohet si më poshtë vijon:

“c) Deklarojnë rezultate me humbje të kapitaleve të veta për të paktën tre vite rresht.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.343, datë 4.10.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.160, DATË 25.1.2007 “PËR
PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË MJETEVE PËR
KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të neneve 201, 203, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 7 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative” të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr.160, datë 25.1.2007, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për rastet kur automjetet ndodhen prej më shumë se 12 muajsh pranë pikave të bllokimit të caktuara nga strukturat e Policisë Rrugore, dhe ende nuk janë dërguar në Rezervat e Shtetit, Komisioni i Vlerësimit të Mjeteve rishqyrton kategorizimin e mjetit dhe merr vendimin përkatës.”.

b) Në pikën 5 fjalët “...me urdhër të Kryeministrit” zëvendësohen me fjalët “...sipas miratimit të organit që ka këtë kompetencë.”.

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me strukturat e rezervave materiale të shtetit, ndërmarrin të gjitha masat për:

a) rivlerësimin e kategorizimit të mjeteve sipas pikës 1 shkronja “a” të këtij udhëzimi;

b) transferimin e dokumentacionit dhe të mjeteve pranë drejtorive rajonale të rezervave materiale të shtetit;

c) transferimin e dokumentacionit pranë rezervave materiale të shtetit, kur në raste të caktuara drejtoria rajonale e rezervave materiale të shtetit jep paraprakisht pëlqimin për zhvillimin e procedurave të ankandit publik pa u transferuar mjetet nga vendndodhja e tyre aktuale.

3. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, si dhe strukturat në varësi të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.10.2010
Doli nga shtypi më 7.10.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë